



# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.6(443)

QERSHOR 2025

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

**DOSSIER**

**SHTËPIA E QEMAL STAFËS DHE NJË RRËFIM PËR PERLAT REXHEPIN**



Gëzim Llojdia

FAQE 4-5

**NDERIMI**

**DËSHMORËT E XHENIOS SHQIPTARE NË NJË LIBËR**




Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj - Mjeshtër i Madh

FAQE 14

**DËSHMORË TË PASHPALLUR**

**ZEQIR AGË PUKA DHE IBRAHIM KURTI**



Xhemal MEÇI-Mjeshtër i Madh

FAQE 8

80 VJETORI I FITORES MBI NAZIFASHIZMIN - FEDERATA SHQIPTARE E VETERANËVE TË LUFTRAVE PËR LIRI E

## TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU: KRENARË

## QË JEMI PASARDHËS TË FITIMTARËVE

**FI TORJA E DYTË MË E MADHE NË HISTORINË TONË**

Në këtë jubile të 80-vjetorit të fitores së madhe të bllokut antifashist, ne shqiptarët kemi të drejtë të krenohemi për Luftën tonë të lavdishme, për sakrificat mbinjerëzore dhe gjakun e dhjetëra mijëra dëshmorëve që u bënë pjesë e bllokut antifashist të popujve të botës të kryesuar nga Aleanca Anglo - Sovjeto-Amerikane.

VIJON NË FAQEN 2



FAQE 2

• *Kryesia e OBVLP falenderon strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes, veçanërisht Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, që mundësuan pjesëmarrjen e delegacionit të saj në këtë Aakedemi Jubilarë 81 VJETORI*

**Brigada XV Sulmuese u pagëzua në Operacionin e Qershorit 1944**

FAQE 7

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

**SUPEMENTI LETRAT**

**Xhafer Matuka shkroi për luftën, për heronjtë dhe për ushtrinë**

Nga Sakip Cami

FAQE 13

**POEZI**

• *Heronjtë...nga Qazim D. Shehu*

• *Një trup, një shpirt...*

Nga Arben Alliu

FAQE 13

**PROMOVIMI**

Libri "Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave" promovohet në radio Kosova e lirë

**Libri i Halil Ramës, pikë reference për brezat e ardhëshëm**

Evidentimi i vlerave të shqiptarëve të të gjitha fushave dhe të gjitha periudhave të historisë shqiptare, është mision i çdo studiuesi

Tefta Cami-Cani

Ish-Ministre e Arsimit dhe Kulturës

FAQE 8



TEFTA CAMI-CANI: EVIDENTIMI I VLERAVE TË SHQIPTARËVE TË TË GJITHA FUSHAVE DHE TË GJITHA PERIUDHAVE TË HISTORISË SHQIPTARE, ËSHTË MISION I ÇDO STUDIUESI

**HISTORIA**

**PËRBALLIMI I OPERACIONIT TË QERSHORIT 1944**

FAQE 6

**HOMAZH**

**BASHKIM DUMANI NUK U JOSH NGA PASURIA**

FAIK KHANI-Mjeshter i Madh

FAQE 10

**REKUIEM**

**DËSHMORËT E RINJ TË FSHATIT VAJZË NË LABËRI**

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

FAQE 11

**PROFILI**

**PËR VETERANIN E KUFIRIT LENIN MARK NDRECA**

MEVLUD BUCI

FAQE 11

**SKICË**

**KRYEFAMILJARI MODEL QEMAL RAMADAN ZEQAJ**

Zef Rrozhani

FAQE 10

## SPECIALE

## 80 VJETORI I FITORES MBI NAZIFASHIZMIN - FEDERATA SHQIPTARE E VETERANËVE TË LUFTRAVE PËR LIRI E PAVARËSI – SESION JUBILAR NË GJAKOVË

### TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU:

# KRENARË QË JEMI PASARDHËS TË FITIMTARËVE

- *Populli ynë në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi dhe kudo në trojet etnike është krenar që u bashkua me luftën në Aleancën e Madhe Antifashiste të popujve. Trojet tona jo vetëm që u çliruan pa ndërhyrjen direkte të forcave aleate, por dhanë një kontribut të çmuar në këtë luftë*



Federata Shqiptare e Veteranëve të Luftërave për Liri e Pavarësi, në përbërje të së cilës janë OBVLP e Shqipërisë dhe Organizata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës, 80-vjetorin e fitores mbi Nazifashizmin e shënoi me një Akademi Jubilarë që u mbajt në Gjakovë (të premtën më 9 maj 2025), me pjesëmarrjen e qindra veteranëve të LANÇ e të UÇK-së dhe pas-adhësve të tyre, mes të cilëve dhjetra akademikë nga Prishtina e Tirana.

Këtij eventi mbresëlënës i parapriu vendosja e kurorave me lule të freskëta në varrin e Heroit të Popullit Fadil Hoxha e Vahide Hoxha dhe në varrezat e dëshmorëve të UÇK-së.

Hapja e eventit u bë nga kryetari i Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës, dega në Gjakovë, Gazmend Hoxha. Më pas vijuan me fjalët përshëndetëse, kryetari i Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës, Lekë Hoxha dhe Tatjana Parllaku, kryetare OBVLP Shqipëri .

Akademik Jusuf Bajraktari mbajti referatin : “Idealizmi shqiptar në përthyrjet dramatike të Luftës së Dytë Botërore”,

Akademik. Marenglen Verli referoi mbi “Faktorët që penguan Fuqitë e Boshtit të kryenin rekrutimin masiv në Kosovë”, ndërsa Prof. Gëzim Ibrahim Prengzi foli mbi Pasojat që ka pas Malësia e Gjakovës pas mohimit të vendimeve të Konferencës së Bujanit. Nën kryetari i OVLANÇ të Kosovës Bashkim Hisari (në fjalën e mbylljes) vlerësoi kontributin e dy organizatave tona në ruajtjen dhe promovimin e vlerave të LANÇ e të UÇK-së.

Përshëndeta edhe unë në emër të kryesisë së OBVLP të Shqipërisë, si më poshtë:

#### FITORJA E DYTË MË E MADHE NË HISTORINË TONË KOMBËTARE

Në këtë jubile të 80-vjetorit të fitores së madhe të bllokut antifash-

ist, ne shqiptarët kemi të drejtë të krenohemi për Luftën tonë të lavdishme, për sakrificat mbinjerëzore dhe gjakun e dhjetëra mijëra dëshmorëve që u bënë pjesë e bllokut antifashist të popujve të botës të kryesuar nga Aleanca Anglo - Sovjeto-Amerikane.

Në Luftën Anti-Fashiste në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi e kudo, ku jetonin shqiptarët në trojet e tyre etnike, ata ju bashkuan njëzëri forcave të lirisë kundër atyre të errësirës. Me sakrificat e partizanëve shqiptarë u arrit jo vetëm pavarësia e Shqipërisë, por edhe e drejta e shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje dhe e shqiptarëve, kudo që jetonin, për të qëndruar në trojet e tyre etnike.

Kjo ishte fitorja e dytë më e madhe në historinë tonë kombëtare pas shpalljes së pavarësisë dhe ngritjes së flamurit në Vlorë.

Në Luftën e Dytë Botërore i gjithë populli shqiptar ishte në rrezik. Shqipëria mund të humbiste pavarësinë. Populli shqiptar i Kosovës dhe shqiptaret e tjerë në trojet e tyre etnike mund të shpërnguleshin dhe të pësonin fatin e shqiptarëve që u dëbuan me forcën e armëve nga serbët në vitet 1870 – 1980, nga zonat e Nishit, Vranjes, Prokupjes, Leskocit etj, si edhe te popullit Cam.

#### MBËSHTETJA DHE NDIHMA E ALEATËVE ANGLO-AMERIKANË

Na fjalën time iu referova librit Testament per Brezat, “Memoria historike e Kombit”, të gjeneral Rahman Parllakut, Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, I cili deklaroi se po të mos kishte filluar dhe të zhvillohej më tej Lufta Nacionalçlirimtare, kombi shqiptar do të kishte shkuar ne humnere bashkë me nazifashistet dhe do të ishin plotësuar lakmitë grabitqare sllavo-greke për copëtimin e shtetit shqiptar, për të cilat punonin fuqishëm qeveritë mbretërore greko-serbe në egzil.

Zhvillimi i Luftës Nacionalçlirimtare e përfshiu të gjithë Shqipërinë dhe brenda vitit 1942 u krijuan 22 çeta prtizane nga Konispoli në jug deri në Malësinë e Gjakovës në Veri. Jehona e kësaj lufte bëri që ministrat e jashtëm të Anglisë – Iden, i Bashkimit Sovjetik – Molotov dhe i SHBASë – Hill, në dhjetor të vitit 1942, të deklarorin se dëshironin ta shikonin Shqipërinë të çliruar nga zgjedha Italiane dhe të vendosej pavarësia e saj. Forma e regjimit dhe e qeverisë që do të vendosej në Shqipëri do të ishte një çështje që do ta vendoste vetë populli shqiptar në mbarim të luftës. Në këtë deklaratë qeveria angleze ishte e rezervuar kur shprehej se e shikon-

te çështjen e kufijve të Shqipërisë pas luftës, si një çështje që duhej të merrej në shqyrtim në Konferencën e Pages. Keshtu kjo deklaratë u bë mbështetje për qeveritë greko-jugosllave në egzil që po përgatishnin plane për copëtimin e Shqipërisë.

Lufta Nacionalçlirimtare mori zhvillim të vrullshëm me krjimin e reparteve sulmuese të Ushtrisë Çlirimtare dhe me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm, ne 10 Korrik 1943. Shtabi centralioi veprimet luftarake duke shtuar goditjet kundër pushtuesve dhe duke krijuar zona të lira. Në këtë kohë Aleatët e në rradhë të parë Anglezët dërguan përfaqësuesit e tyre pranë Shtabit të Përgjithshëm, të cilët ndiqnin nga afër Luftën tonë Çlirimtare dhe u bindën se e vetmja forcë ushtarake e organizuar në Shqipëri që bënte luftë të vendosur kundër pushtuesve Nazifashiste ishte Ushtria Nacionalçlirimtare. Të bindur për këtë ata i shtuan misionet e tyre në vendin tonë dhe filluan të na ndihmojnë me armatime dhe materiale luftarake, ndonëse të kufizuara për shtimin dhe zgjerimin e ushtrisë sonë gjatë viteve 1943-1944. Nga ana tjetër përfaqësuesit e ushtrive aleate bënë të gjitha përpjekjet e mundshme për të bashkuar dhe futur në luftë forcat nacionaliste të Ballit Kombëtar dhe Legalitetit por pa sukses.

#### ZGJERIMI DHE ORGANIZIMI I LANÇ

Me thyerjen e operacionit gjerman të Qershorit '44, i fundit i ndërmarrë nga nazistët në vendin tonë, në korrik 1944 forcat e Divizionit të Parë kaluan në mësymje për çlirimin e Shqipërisë së Mesme e të Veriut, dhe me çlirimin e Matit, të Dibrës e të Lumës, Brigada e Pestë u shkëput nga varësia e Divizionit të Parë, dhe sëbashku me Brigadën e Tretë morën urdhër të kalojnë në Kosovë për të ndihmuar në çlirimin e saj.

(Vijon në faqen 3)

## SPECIALE

# TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU: KRENARË QË JEMI PASARDHËS TË FITIMTARËVE

- *Kryesia e OBVLP falenderon strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes, veçanërisht Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, që mundësuan pjesëmarrjen e delegacionit të saj në këtë Aakedemi Jubilare*



(Vijon nga faqja 2)

Detyra kryesore që na ngarkonte Shtabi i Përgjithshëm ishte që, në bashkëpunim të ngushtë me forcat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës, të godisnin pa ndërprerë forcat naziste, të shpejtonim çlirimin e Kosovës, të ndihmonim që rinia kosovare të merrte pjesë masive në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, dhe me qëllim që Kosova të bëhej pjesëtare e aleancës antifashiste të popujve që luftonin kundër nazistëve dhe në këtë mënyrë të fitonte të drejtën për vetëvendosje; si edhe të ndihmonim për ngritjen e Këshillave Nacionalçlirimtare në zonat e çliruara.

Për realizimin e këtyre detyrave dhe drejtimin e veprimeve luftarake u krijua Shtabi i Përbashkët Operativ i dy Brigadave tona dhe Forcave të Kosovës, te kryesuara nga Fadil Hoxha - komandant i Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës, Shefqet Peçi - komandant i Brigadës së Pestë dhe Hulusi Spahiu - komandant i Brigadës së Tretë.

Megjithë rezistencën e ashpër të forcave naziste dhe të mbeturinave të Divizionit SS Skënderbeg, për të mbajtur qytetet Prizren, Gjakovë dhe Pejë, si dhe për të siguruar tërheqjen e shpejtë dhe të organizuar të reparteve, për në frontin Perëndimor kundër forcave aleate, forcat tona i mundën dhe i shpartalluan nazistët me luftime shumë të ashpra që u zhvilluan në Gjakovë, sidomos në Junik dhe Deçan.

Në këto luftime, Brigada e Tretë ka pasur humbjet më të mëdha në historinë e saj luftarake, me 32 të vrarë dhe shumë të plagosur. Edhe armiku pati humbje të rënda, me shumë të vrarë dhe të plagosur; gjithashtu u zunë rreth 30 robër nga forcat e Divizionit Skënderbeg.

Partizanët tanë, të zemëruar nga humbja e madhe e shokëve të tyre, kërkuan me këmbëngulje pushkatimin e robërve. Por, me shumë vështirësi, ne i bindëm dhe i liruan të gjithë roberit pasi partizanët e Brigadës së 3-të dhe të 5-të nuk kishin shkuar në Kosovë për të vrarë vëllezërit e tyre, por për çlirimin e

Kosovës.

Atyre iu morën armët, u liruan dhe u porositën që të mos shkonin përsëri në shërbim të armikut që të mos vriteshim vëlla me vëlla, siç ndodhi në ato luftime. Duhet të pohojmë se, pas asaj dite, pushkë kosovari nuk qëlloi më kundër partizanëve shqiptarë.

## PJESËMARRJA MASIVE E POPULLIT TË KOSOVËS NË LANÇ

Luftimet për çlirimin e Deçanit, Pejës dhe gjithë Rrafshit të Dukagjinit përfunduan më 17 nëntor të vitit 1944.

Është e gabuar të thuhet se forcat tona vranë njerëz të pafajshëm në Kosovë. Kjo nuk ka ndodhur në asnjë rast, dhe këtë e dëshmojnë dëshmitarët e gjallë të asaj kohe.

Vrasjet kanë ndodhur vetëm kur forcat kanë qenë ballë për ballë në fushën e luftimit. Kjo e vërtetë u dëshmuar edhe shumë vite më vonë nga ata që u liruan dhe mbeten të gjallë nga ato luftime.

Pjesëmarrja masive në Luftën Na-

cionalçlirimtare e popullit të Kosovës, nën drejtimin e Fadil Hoxhës dhe shokëve të tij, ishte vendimtare. Ajo bëri që të dështojnë planet e Vasa Çubriloviqit, të servirura komandës së ushtrisë jugosllave për spastrimin etnik të shqiptarëve nga trojet e tyre.

Arkitekti i mendimit shovinist serb, Vasa Çubriloviq, me elaboratin e tij të dytë të vitit 1944, jepte direktivën politike se kishte ardhur momenti për t'i "larë hesapet" me shqiptarët njëherë e përgjithmonë, duke i dëbuar ata nga trojet e tyre. Ai pohonte se kurrë më parë nuk kishin pasur kushte më të favorshme për këtë veprim. Në elaboratin e tij ai theksonte: "Lufta është momenti më i përshtatshëm për zgjidhjen e këtij problemi." Çubriloviq shprehte bindjen se aleatët do të kuptonin dhe do të plotësonin dëshirat e Serbisë, duke pasur një shpresë të madhe te Bashkimi Sovjetik.

Në fund, ideologu shovinist serb jepte direktivën për ushtrinë: "Ushtria gjatë operacioneve luftarake duhet të spastrojë në mënyrë të planifikuar dhe të pamëshirshme pakicat kombëtare shqiptare."

Konferenca e "Tre të Mëdhenjve" — Churchill, Stalin dhe Roosevelt — i jepte të drejtë shteteve fituese në luftë për shpërnguljen e pakicave kombëtare që ishin bashkuar me bllokun nazist. Një shembull konkret ishte shpërngulja e më shumë se 10 milionë gjermanëve nga Prusia dhe Kracovia.

Megjithatë, platforma politike dhe ushtarake e Çubriloviqit nuk u zbatua plotësisht. Lufta e Brigadave tona për çlirimin e krahinave të Kosovës dha një ndihmesë të madhe për pjesëmarrjen e djemve kosovarë në luftë.

Me largimin e brigadave tona nga Kosova drejt Sanxhakut dhe Bosnjës, Forcat serbo-sllave u përpoqën të vinin në zbatim planin e Çubriloviqit, por ishte tepër vonë. Shqiptarët, të armatosur dhe të vendosur, bënë një qëndresë të fortë, duke luftuar për jetë a vdekje për çlirimin e vendit të tyre. Në komandën e Shaban Polluzhës, shqiptarët arritën të parandalonin realizimin e këtij plani, duke mbetur përgjithmonë në trojet e tyre etnike.

Forcat e dy divizioneve tona vazhduan luftën në tokat jugosllave, duke dhënë ndihmesën e tyre jo vetëm në çlirimin e krahinave të Malit të Zi, Sanxhakut dhe Bosnjës, por edhe duke penguar dhe dëmtuar forcat naziste që përpiqeshin të tërhiqeshin drejt Perëndimit.

(Vijon në faqen 16)

## DOSSIER

83 vjet nga rënia e Heroit të Popullit Perlat Rexhepi që u bë shembull i heroizmit

# Shtëpia e Qemal Stafës dhe një rrëfim për Perlat Rexhepin

- *Perlat Rexhepi është një nga tre Heronjtë e Shkodrës. Lindi në fshatin Vajzë të Vlorës më 25 tetor 1919 dhe u vra më 22 qershor 1942, nga fashistët. Para vdekjes ka thënë: “Populli do të armatoset e do t’i hedh në det pipinot, siç i hodhën baballarët tanë në 1920-ën në luftën e Vlorës”*



studioz. Nën ballin e gjerë shquheshin dy sytë e vegjël të shkathët, që vrojtonin mbas lenteve, çdo gjë me ngulm e kureshtje. Një ditë, në verën e vitit 1940, një shok i imi më njohu me të. Për mua qe një ngjarje ngazëlluese. Ai më shtini dorën me dashamirësi, thua-jse ishim njohur prej kohe. U bëra gati t’ja shtrëngoja po ndjeva se dora im u ndrydh lehtas në pëllëmbën e tij, dhe u tund disa herë.

-Gëzohem që u njohëm-tha duke vënë buzën në gaz. Zëri i tij kishte një tingull të fortë, të rëndë të qartë. Sytë e tij më kanë mbet të ngulitur në kujtesë. Kishin një ndriçim të zgjuar e dukeshin hijerëndë. Shikimi i tij ishte i kthjelltë dhe i thellë si ujët e liqenit malor. Njeriu shihte në të pasqyrimin e një jetë të brendshme tërë aktivitetet. Cdo herë që e takova më vonë, bëhesha gati disa hapa përpara për ta përshëndetur plot respekt, kërkoja shikimin e tij e mbase e ndeshja luaja kokën vrokthi dhe:

-Mirëmbërëma- i thoshja.

Ai buzëqeshte e më përgjigjej. Për disa kohë u zhdruk. E takova për të fundit herë, në një shtëpi në Dobrac. Ishte i plagosur në këmbë. Dhe ja si kishte ndodhë. Policët e kërkonin gjithandej. Po ai shpesh u kalonte nën hundë me biçikletë. Një ditë kaloi andej nga fabrika e cigareve: “Taraboshi”. Një polic e kishte diktuar. Ai qëllloi, me shpresë se do ta shembte në vend. Ngjau e kundërta. Perlati grumbulloi fuqitë dhe ashtu me plagën, që i kullonte gjak iku...

Pra nesh tregohej krejt i qetë. Fliste e qeshte si të mos kishte asgjë, veçse hera herë, kur lëvizte rrudhat e ballin. Atë cast shiheshin në fytyrën e tij shenjat e dhembjes. Por megjithatë përpiquej ta mbulonte me një buzëqeshje të qetë.

...Shkrimtari Jonuz Dini duke vijuar përshkrimin e tij thotë: “Isha në burg. Po zbardhte dita e 22 qershorit. Më doli gjumi herët nga cimkat dhe vapa. Kuvendoja me Naim Gjylbegun i cili zgjohej zakonisht pa zbardhur drita dhe thithte duhan. Bisedën na e prenë krismat e pushkëve që vinin nga larg, nga thellësia e qytetit. Dolëm jashtë, në atë sheshin e vogël të burgut. Mbas nesh ja behën Ndoc Mazi, Ahmet Haxhija, Ruzhdi Tyli, Reshit Rusi, Fahri Ceni etj. Burgu filloi të gumëzhijë si koshere bletësh. Ai shesh i zbuluar u



mbush me të burgosur sa nuk kishte ku të hidhje mollën.

-Ç’janë këto pushkë bre Ndoc?, -pyeti Doda, një mirditas.

-Populli lufton kundër fashistëve i gjegji Minuku, i bindur për sa thoshte. Dhe kështu, pyetjet e përgjigjet vazhduan. Asnjë nuk dinte gjë. Flitnin me hamendje. Po pushkët nuk pushuan. Disa herë u dëgjuan edhe shungullimet e bombave. Një aeroplan kaloi mbi ne dhe shkoj andej nga bëhej lufta. Neve na vlonte gjaku. Ishim grumbulluar te dera e burgut e shikonim qiellin e copëtuar nga hekurat si zemra jonë nga ankthi.

Shkrimtari J. Dini rrëfen kështu më tej: Padsreke Jonuzi, gardiani i burgut na solli fshehurazi një letër. Një shok shkruante me hare e pikëllim: “Një vit mbas sulmit të pabesë të nazistëve kundër Bashkimit Sovjetik edhe në Shkodërlocja foli plumbi. Komunistët: Perlat Rexhepi, Branko Kadija dhe Jordan Misja luftuan kundër një ushtrie të madhe të motorizuar, tre kundër treqindëvet. Perlati u bë shembull i heroizmit. Edhe pse u dogj shtëpia dhe flakët filluan t’ia përcëllonjë trupin ai qëndroi dhe luftoi deri sa u fik. Ndërsa një shok lexonte, zemrat tona mbusheshin me frymëzim revolucionar. Sytë e Ndocit, Naimit Ahmetit e sa e sa të tjerëve, që do të ndiqnin shembullin e Perlatit) vetëtinin nga urrejta si vetëtimat ndër netët e errtë të vjeshtës.

**“PYETA LABËRINË, E KU ËSHTË PERLATI?/ KOMBI ULËRINË MË SHUMË SE I MATI”**

**Perlat Rexhepi** është një nga tre Heronjtë e Shkodrës. Lindi në fshatin Vajzë të Vlorës më 25 tetor 1919 dhe u vra më 22 qershor 1942, nga fashistët.

Para vdekjes ka thënë: “Populli do të armatoset e do t’i hedh në det pipi-

not, siç i hodhën baballarët tanë në 1920 në luftën e Vlorës.”

Poeti Ali Asllani që e kishte mik të ngushtë dhe ishte rritur në shtypin etij shkruan: “Pyeta Labërinë, e ku është Perlati?/ Kombi ulërinë, më shumë se i ati, / Pyeta djalërinë, ç’e bëtë shokun, mikun?/ Nder për Shqipërinë, vdekje për armikun./ Tani tinë dhe unë, e dimë për Perlatin,/ Djep kishte Beun, varr ka Rozofatin!...”

Publicisti Agim Jazaj ka shkruar: “Rexhep Sulejmëni, i ati i perlat Rexhepit, ishte një ndër figurat më të shquara, pjesëtar aktiv në “Luftën e Vlorës”, më 1920. Si shumë patriot vlonjatë, mori pjesë e luftoi si burrat në revolucionin “Demokratiko-Borgjez”, që udhëhiqte Noli. Pas këtyre ngjarjeve, detyrohet të marrë arratinë me gjithë familjen dhe vendoset tek miqtë e tij, në ishullin e Korfuzit, për t’i shpëtuar persekutimit të regjimit zagollian, si kundërshtar politik. Perlati ishte vetëm 5 vjeç. Në moshën 6 vjeç, filloi shkollën fillore, ku mësonte midis nxënësve grek, në gjuhë të huaj, me mësues grek e italian. Perlati fliste, shkruante dhe komunikonte me mësuesit grek e italian, pa asnjë pengesë e dallim, madje dhe mbi të tjerët. Pas shumë përpjekjesh të të atit, Perlati vazhdoi rrugën e dijes në shkollën “Tregtare” të Vlorës, në klasat përgatitore, siç quhej, semimaturë, ku vazhdoi dy vjet e më pas studimet e plota për 6 vjet. Edhe aty ra në sy veprimtaria e tij atdhetare dhe e përjashtojnë nga shkolla. Më pas ati i tij e mundësoi shkollimin e tij për gjeometër, në shkollën “Teknike”, ku studionte dhe libra jashtë shkollore, si romanin: “Nëna” i Maksim Gorkit, “Puna me mëditje: dhe “Manifest” PKSH, si dhe gazeta e revista të huaja, të botuara

(Vijon në faqen 5)

## Gëzim Llojdia

Po sjellim një rrëfim të panjohur për Perlat Rexhepin, vrasjen e të cilit poeti Ali Asllani e thotë: “Pyeta Labërinë, e ku është Perlati?/ Kombi ulërinë, më shumë se i ati”

### NGA RRËFIMI I SHKRIMTARIT JONUZ DINI

Të dielën e 30 tetorit 1966 shkrimtari Jonuz Dini sjell një përshkrim te gazeta letare: “Drita” kushtuar Heroit vlonjat Perlat Rexhepi. Shkrimtari J. Dini është ndarë nga jeta në vitet 80 dhe aso kohe te gazeta: “Drita” botova një shënim të vogël kushtuar botimit të librit të këtij autori nga ku aty mësova se autori nuk rronte më.

Viojmë më tej. Në faqen 3 të së dielës së 30 tetorit po te gazeta: “Drita” gjeta këtë shkrim të autorit Jonuz Dini kushtuar trimit nga vajza e Vlorës Perlat Rexhepi.

Autori e nis rrëfimin: “Më kishte tërhequr vëmendjen disa herë ky djalos që shihej shpesh duke shëtitur nëpër Fushë të Celës, porsa muzgu shtrinte napën e tij të murrme mbi qytetin tonë. Shtat hollë mesatar. Vishte një pardesy të bardhë që i mbulonte gati gjysmën e çizmeve të lustruar me kujdes, ecte me një hap të rëndë ushtararak. Mbante një kasketë kafe të mbylur. Fytyra e tij e mprehtë dhe pak e zbehtë, të krijonte përshtypjen e njeriut

## DOSSIER



BRANKO KADIA



PERLAT REXHEPI



JORDAN MISJA

# Shtëpia e Qemal Stafës dhe një rrëfim për Perlat Rexhepin

(Vijon nga faqja 4)

jashtë vendit nga Halim Xhelua. Ai lexonte Naimin, Çajupin, "Historinë e Skënderbeut", si dhe poetin me famë Ali Asllani, gjigantin e poezisë, edhe ky bir i fshati të Vajzës! Pushtimi i Shqipërisë më 7 Prill 1939, solli dhe mbylljen e shkollave, dhe përndjekjen e Perlatit, i cili për t'i shpëtuar, vendoset në vendin më të afërt, në Mali i Zi, pa asnjë ndihmë ekonomike fal, bujarisë së shqiptarëve aty, qëndroi në shtëpitë e tyre 3-4 muaj, me shpenzimet e tyre. Perlat Rexhepi, ndodhej gjithnjë prezentë midis njerëzve të punës dhe aksioneve. Dyshimet e drejtuesve bënë të largonin Perlatin nga qyteti i Vlorës për në zonën e Sevasterit, gjoja për të projektuar rrugën e re, që fillonte nga Peshkëpia, Gorishti e Dushkaraku, për të dalë në Memaliaj, gjatë buzës së Vjosës. Perlatin me shokët e tij, edhe aty i kishin thirrur e paralajmëruar nga kuestura. Kjo arsye bëri të transferohej më pas në Shkodër. Zyra e gjeometrit nga Vlora, në Shkodër e bashkoi me shumë njerëz të mirë, në punë dhe jashtë sajë. Shumë shpejtë u bë i njohur jo vetëm si specialist, por dhe si njeri me njohuri të thella. Në Shkodër Perlatin e donin dhe respektin, jo si jabanxhi, por dhe si i ardhur nga Vlora. Perlati, së bashku me Jordan Misjen, strehohej në shtëpinë e këtij të fundit. Shokët e këshillonin, të ruhej, nuk i flisnin as në emër, po me pseudonim "Tarzani". Ai fliste shumë rrjedhshëm në dialektin shkodran. Komiteti Qarkor kishte vendosur të kryenin një aksion për djegien e kuesturës fashiste. Këtë aksion e mori me shumë dëshirë përsipër Perlat me njësitin gueril. Në kohën kur Perlati i fliste rojës, shokët e tij hodhën lëndën ndezëse dhe i vunë flakën kuesturës. Në moment kuestura mori zjarr. Fashistët u tmerruan dhe u alarmuan, ndërsa guerrillasit u larguan me shpejtësi, pa pësuar asnjë gërvishtje.

## SHTËPIA KU LINDI QEMAL STAFI

Qemali 21 vjeç dhe Perlati 23 vjeç.. I bashkoi Shqipëria, i vrau pushtuesi. ...Lufta nuk ishte një valë baticë e ngatërruar me një valë. Ishin fatkeqësisht disa vjet. Ishte kohe për vdekje. Vdekja duke fshehur vdekjen nga vdekja Gdhije në muzg, niseshe dhe përfundojë në muzg. Tokat e vëna nën sundim ishin gjithmonë, gri. Dhe qyteti, rrugët, sokakët, pylli, livadhi, mali dhe krejt njerëzia ishin vënë nën sundim gri. Topa, tanke, mortaja, pushkë, fishekë, fashistë, nazistë ishin gjithmonë gri. Edhe dasmat e mëdha ishin gri. Edhe tregjet gri. Lumenjtë, liqenet dhe deti, sigurisht mbeteshin gri. Nën pushtim dhe nën terror dominonte ngjyra gri. Dhe një ngjyrë tjetër, përshkonte, qytetet shqiptare në luftën e dytë. Ngjyra e kuqe e gjakut të djelmoshave shqiptarë. Një nga ëndrrat e heronjve të luftës së dytë, të kenë atdheun e tyre pa pushtonjes. 21-Qemali dhe 23 vjeç Perlati. Lufta përfshiu disa breza. Dy djem shqiptarë i njëjti fat. Luftuan për atdheun deri në pikën e fundit i vrau pushtuesi. Qemal Stafa dhe Perlat Rexhepi. Dhe kanë pasur shumë ëndërra. Dhe jetën, lumturinë, lirinë, të qeshurat e fëmijëve, qytetin e tyre atdheun. Sigurisht që i donin pa kufi. Dhe shprehja, që sot gjen vend ndër luftërat e botës: nëse duhet vdes, vdes për kombin tënd. Dhe në gjithë luftërat pushtuesi, asnjëherë nuk kërkoi falje. As në kohët e hershme. As në kohët e sotme.

Po ku gjendej aso kohe, shtëpia ku lindi Qemali? Po sot ku gjendet shtëpia e një heroit njëzet e një vjeçar, të Luftës së Dytë Botërore?

Kartela e Drkk. Lista e monumenteve rrethi i Elbasanit 2017, sjell këto të dhëna:

- Banesa e Qemal Stafës është një monument i trashëgimisë kulturore në rrethin e Elbasanit në qarkun e Elbasanit Shqipëri.

Ky monument është i llojit "Arkitek-

turë / Urbanistike", i miratuar me numër "1886 më 10.06.1973".

Banesa e Qemal Stafës: Lloji: Arkitekturë/urbanistikë.

Vendodhja: Elbasan Shqipëri.

Kordinatat: 41o06'40"V200o5'06"L.

Ndërtuar: Shek. XX.

Organi Drejtues: DRKK Durrës.

Monument kulture në Shqipëri: Emri zyrtar: Monument i trashëgimisë kulturore, nën mbrojtje.

Kriteret: I. Përcaktuar 10.06.1973.

Nr i referencës: EI012.

## QEMALI U VRA NGA PUSHTUESI, PO KUSH E TRADHTOI VALLË HEROIN 21 VJEÇAR?

Aso kohë dihej se Qemali u vra nga pushtuesi, po kush e tradhtoi vallë heroin 21- vjeçar? Pse të gjithë pjesëtarët ku gjendej edhe heroit në atë shtëpi shpëtuan, ndërsa heroit vdiq, i vranë nga pushtuesi italian?

Aso kohe, pranverë e vitit 1942.

Po thureshin ëndrra. Pritej që, liria të kishte punë me armët dhe më tej me sakrificat të mëdha.

Do të nisej në jug, ku gjente aromë deti. Qyteti që do të shkonte quhej Vlorë, sapo të fekste dita. Mirëpo, karabinierët rrethuan shtypin dhe vranë djalosin shqiptar. Një 21 -vjeçar vritej me tre plumba mizorisht te varri i Bamit. Dhe po të ndjekësh tekstin e këngës thuhet qartazi.

Kush e tradhtoi 21 -vjeçarin, heroin e madh të një populli?

Ç'e ndoqën nga mbrapa spiunët e djallit .Kush ishin spiunët dhe përse emrat e tyre nuk u vendosën në shtyllën e turpit për tradhëtinë ndaj shqiptarëve? Ja dhe teksti i këngës: Afër një spitali/ç'u vra Qemal Stafa/një trim nga të malit./Ç'e ndoqën nga mbrapa spiunët e djallit/luftoi me patllake/gjersa i doli xhani./Nëna e tij plakë/shkon e qan tek varri/ngrehu Qemal i thotë/ç'bën tek varri Bamit./Dje më erdhi karta/nga trimat e malit ngrehu të keqen nëna/të duan partizanët./Kam marrë tre plagë/

plumba italianit/të më merret haka/gjakun mos ma falni./Popullit shëndënë/ u vra si luani/nënë lamtumirë /i thotë Qemali.....

Erdhi në jetë në qytetin e Elbasanit, i biri i Hasan Ahmetit dhe Sabries së Veli Dylgjerit. Më tej bëhet me një grup shokësh Zef Malaj, V. Shanto, Gj. Lukën, T. Jakova, themelues të grupit komunist të Shkodrës, ai nxënësi i kolegjit Kasverian te etërve jezuit.

## NJË ESSE E SHKRIMTARIT MUSA VYSHKA

Në 25 vjetorin e rënies. 1967. Atje në qytetin e Elbasanit. Shkrimtari M. Vyshka ka thurur një esë më stilin e tij të bukur. Le të shkëputemi nga kjo frazë së paku.

.... Është pesë maji, shkruan autori, dhe im atë kujdestari i shtëpisë muze të Qemalit ka shumë punë. Një për shkallët e ngurta që të shpien te dhoma ku lindi ai, trokasin me ngadalë këmbët e ushtarëve, vullnetarëve, nxënësve tanë. Këtu ka lindur Qemal Stafa, heroit i popullit tonë dhe imë atë që mund ta ketë thënë qindra herë këtë frazë, do të ndjejë përsëri një emocion të ri. Erdhi pranvera, shkruan në vitin 1967 te gazeta: "Drita", shkrimtari M. Vyshka: dhe zambakët kanë çelur te oborri, ata janë të bardhë të bardhë. Kurse 5 maji është dita e zambakëve të kuq, që çelën pas të njëzetmijëve. Prej ngjyrës së kuqe të gjakut u zbardhë kaq e bukur dita jonë, Prej ngjyrës së kuqe të gjakut të Qemalit, që lindi këtu në mëhallën time. Hyj në dhomën ku lindi ai. a djepi i tij. Aty u përkund dhe qau, shkruan autori. Nëna e përkulur sipër djepit të heroit, pa ëndrra t' bukura. Iu duk sikur ky fëmijë do të bëhej ndonjë dijetar i madh, me siguri do të bëhej. Si të gjitha nënat e botës edhe ajo u mundua ta përfytyroj të birin në ndonjë klasë duke dhënë mësim, apo kushedi se ku. Por ai u bë më i madh se mund të ëndërrojë një nënë. Ai u bë i pavdekshëm. Prapa derës ku u rrit ai të mbuluar me strehë rrinin ulur lapsat dhe gështenja pjekësit. Vetëm kjo dhomë ka dëgjuar britmat e tij fëmijore. Në dhomat tjera janë plaçka, rrobat, fletoret, ato janë plakur, por e mbajnë veten me kurajo. Duhet të qëndrojnë patjetër. Ato i duhen kësaj toke, i duhen këtij brezi. Dhe brezave që vijnë, i duhen sepse janë të Qemalit. Më kujtohet mirë njohja me këtë shtëpi thotë M. Vyshka. "Atëherë isha i vogël dhe sapo kisha hyrë në shkollë. Kisha dëgjuar për heronj, për partizanë, por nuk përfytyroja dot asgjë. Shkolla jonë ishte vetëm disa metra larg shtëpisë ku lindi Qemali. Ahere këtu banonin disa familje, banonte dhe një moshatari i im. Ai ishte një fëmijë i urtë dhe i drejtë, por megjithatë askush nuk i besoi kur na tha se te dhoma ku flinte ai, kishte lindur Qemal Stafa. Ne filluam të qeshnim sepse nuk na besohej. Kjo ishte diçka pamundur. Dilte krejt në kundërshtim me përfytyrimet tona. Heronjtë duhej të lindin nëpër shtëpia të rralla, jo aty ku banon një fëmijë sa ne. Pastaj ajo shtëpi ishte vjetër e vogël. Dhe kjo zgjati shumë, ai u betua për këtë por ne nuk besuam. Që atëherë lagja mori një dritë të re. Mbas ishte drita e re që lëshonin sytë e tij. Ai ishte vetëm njëzet e një vjeç kur ra. Dhe ishte aq i madh një njëzetvjeçar, aq i lavdishëm. Kështu do të mbetet gjithnjë, njëzet e një vjeç....

(Marrë nga Gazeta Destinacioni, 5 maj 2025)

## HISTORIA

*Forcat partizane, duke shmangur luftën ballore, kur ato viheshin në rrezik, arritën të dalin me sukses nga rrethimi*

# Përballimi i Operacionit të Qershorit 1944

## SITUATA E PËRGJITHSHME NË PRAG TË OPERACIONIT

Kongresi i Përmetit analizoi dhe mori vendime të rëndësishme për ecurinë e LANÇ-it deri në çlirimin e plotë të vendit. Në fushën ushtarake me rëndësi ishin vendimet për forcimin e mëtejshëm dhe zgjerimin e UNÇSH, njësimi i Komandës së Përgjithshme, vendosja e gradave në ushtri, si dhe gërshetimin e shërbimit vullnetar dhe të detyrave ushtarake që do të realizoheshin nga LANÇ. Kongresi i Përmetit dha orientimin që Ushtria Nacionalçlirimtare të kthehej në ushtri të rregullt duke organizuar batalionet e grupet në brigada, brigadat në divizione dhe divizionet në korparmata. U shtrua detyrë para Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar të kërkohej ardhja pranë Shtabit të Përgjithshëm i misioneve ushtarake amerikane dhe përfaqësues nga BS.

Shtabi i Përgjithshëm, që gjatë zhvillimit të Kundërmësymjes Pranverore të UNÇSH-it, me qëllim që të mos lëshonte nismën operative, kishte hedhur idenë e kalimit në mësymje të përgjithshme për realizimin e objektivave vendimtare e strategjikë për çlirimin e gjithë vendit. Vendimet e Kongresit të Përmetit në fushën ushtarake mundësonin një detyrë të tillë që do të materializohej me çlirimin e krahinave të gjera, si dhe të qyteteve kryesore, duke kaluar në çlirimin e gjithë vendit. Kjo, sikurse u theksua edhe në Kongresin e Përmetit, mundësohej edhe nga zhvillimi i luftës në frontin e Lindjes e të Perëndimit, ku forcat gjermane kërcënoheshin të rrethoheshin në Ballkan (dalja e Frontit të Lindjes në kufijtë e Ballkanit dhe mundësitë e zbarkimit të aleatëve në këtë hapësirë). Nisur nga këta faktorë, u konceptua dhe u përgatit plani i mësymjes së përgjithshme. Por fillimi i saj u shty për më vonë, sepse komanda gjermane ndërmoi një tjetër operacion të madh mësymës, si ai i dimrit për asgjësimin e UNÇSH-it, shkatërrimin e pushtetit të Këshillave NÇ dhe asgjësimin e shpinës së forcave në vijën bregdetare, por edhe për të liruar forca për t'i përdorur në Frontin e Lindjes.

Thelbi i idesë së komandës gjermane ishte që, duke dhënë goditjen fillestare me forca të kufizuara për bllokimin, shtyrjen në drejtim të jugut e perëndimit të forcave partizane, kryesisht me grupet e luftimit "Shatjer" dhe "Burgmaester", t'u krijonte kushte forcave kryesore, për të kaluar në mësymje, por dhe me drejtime e me kolona (hapësira në mes të kolonave do ta mbulonin forcat xhandaro-balliste), të shtynte më tej forcat partizane, t'i detyronte ato të kalonin në krahun e majtë të lumit Vjosa dhe, në të pastajmen, me goditje bashkëqendrore nga drejtime të ndryshme, t'i asgjësonte ato në hapësirën Mesaplik-Kurvelesh-Bregdet. Në themel të operacionit u vu taktika kundërpazane me metodën e fshirjes dhe të asgjësimit pjesë-pjesë.

Në këtë operacion, komanda gjermane, për arritjen e objektivave të caktuar, parashikonte të mbante një qëndrim të ashpër edhe ndaj "popullsisë paqësore" në qendrat e krahinat e pushtuara prej tyre. Prandaj, në pjesët e vendet ku janë pikat nevralgike të çetave partizane, e gjithë popullsia duhet të konsiderohet e



trajtohet si armike.

## MËSYMJA GJERMANE

Komanda gjermane, për të garantuar suksesin e goditjes vendimtare për copëtimin e asgjësimin e forcave partizane, vendosi që para fillimit të mësymjes përfundimtare të ndërmerre disa veprime paraprake për të mbledhur në një zonë gjithnjë e më të ngushtë forcat partizane në zonën Mesaplik-Kurvelesh-Bregdet. Komanda e Br.VIII S dhe ZIOp. manovruan forcat e veta në krahë e në shpinë të armikut duke mos i dhënë atij beteja ballore në drejtimet e lëvizjes së tyre. Një pjesë e forcave të Br.VIII S ishte në territorin grek për të bashkëvepruar me Regj.15 të ELAS-it në dhënie e goditjes në shpinë të armikut. Forcat gjermane mësynë në mënyrë koncentrike nga disa drejtime për të dalë në Kurvelesh si epiqendër e operacionit.

Sulmi i forcave gjermane u ndërmor fillimisht në luginën e Shushicës. Forcat gjermane i detyruan forcat partizane të tërhiqeshin në thellësi, në një zonë gjithnjë e më të ngushtë në Kurvelesh dhe në Kuç. Forcat gjermane arritën të ngjiten në Kurvelesh, duke thyer kështu qëndrësën e forcave partizane. Kishin ngelur ende të papushtuara nga gjermanët: një rrip i ngushtë malor, vargmali në lindje të Bolenës-Çipini-Vërmikut dhe mali i Këndrevicës, gjithsej vetëm rreth 70 km<sup>2</sup>.

Gjendja e forcave partizane paraqitej shumë kritike. Faktikisht komanda gjermane kishte arritur të realizonte idenë e përqendrimit të forcave të shumta partizane në një hapësirë të ngushtë. Mbetej të jepej goditja vendimtare për copëtimin dhe asgjësimin e tyre. Në këtë hapësirë të vogël, forcat partizane nuk e kishin të lehtë të manovronin. Komandat e njësive partizane, në këshillim me njëra-tjetrën, morën vendimin më të drejtë të mundshëm për gjendjen: të shkëpusin kontaktin luftarak me armikun duke dalë në krahë e në shpinë të tij e më pas nëpër rajonet e tyre të veprimeve luftarake. U përcaktuan edhe sektorët e drejtimeve nga mund të dilej nga rrethimi për çdo formacion. Br. VI S të çante rrethimin në drejtimin e Gjirokastrës dhe pasi të kalonte në prapavijë, të përqendrohej me batalione në rajonin mali i Kocunit, Babrushit, Kaparjelit dhe të Zhulatit; Br.XII S të çante në verilindje dhe të dilte

në Golem e Cepo. Po kështu u caktuan hapësirat edhe për forcat e pakta të njësive të tjera. Forcat u vunë në lëvizje për të dalë nga rrethimi, por vetëm Br.III S mundi të dalë pa u ndeshur me forca armike dhe u përqendrua në Progjëri. Forcat e ZIOp manovruan në malet e Kurveleshit.

## PËRBALLIMI I OPERACIONIT DHE RIVENDOSJA E GJENDJES

Me gjithë situatën e vështirë të krijuar në zonën e Kurveleshit e në Shur, forcat partizane, mbështetur në parimet e taktikës së luftës partizane dhe duke shmangur luftën ballore, kur ato viheshin në rrezik, arritën të dalin me sukses nga rrethimi. Por kishte edhe faktorë të tjerë, si ruajtja e qetësisë, njohja dhe shfrytëzimi me mjeshtëri i terrenit etj., që kushtëzuan daljen nga rrethimi.

Me daljen e forcave partizane nga rrethimi në grykën e Shurit, në fakt mbaroi edhe mësymja e përgjithshme gjermane. Forcat partizane të ZIOp dhe ato të UNÇSH në këtë zonë, nën trysninë e epërsisë së madhe të armikut dhe për ruajtjen e forcave të veta nga asgjësimi, lanë hapësira të konsiderueshme. Komanda e Përgjithshme dhe ZIOp, mbështetur në konceptet e taktikës së luftës partizane e duke i zbatuar ato në fushat e betejave, në zhvillimet konkrete të veprimeve luftarake, vlerësuan e realizuan, si një element të pandarë të veprimeve mbrojtëse, sulmet, kundërsulmet e kundërgoditjet deri në kundërmësymje. Pikërisht nëpërmjet këtyre veprimeve aktive dhe të pandërprera, komandat partizane rimerrnin hapësirat që pushkonte armiku gjatë mësymjes së përgjithshme. Në këtë kuadër forcat e ZIOp dhe të brigadave që vepronin në Zonë, ndërmoren një sërë goditjesh kundër forcave gjermane, që vepronin në Kurvelesh, Mesapli e Bregdet, veçanërisht kundër atyre që lëviznin gjatë luginës së Drinos dhe në grykën e Këlcyrës. Br.VIII S dhe forca të ZIOp kaluan në mësymje në drejtimin Përmet-Këlcyrë dhe Çajup-Gjirrokastër; Br.III S dhe forcat territoriale në Dangëlli. Forcat e tjera të ZIOp dhe të njësive të UNÇ, që gjendeshin në zonë, vijonin veprimet luftarake kundër grupimit të forcave armike në Mesapli-Kurvelesh e Bregdet. Në këtë mënyrë, ndërsa në këto

hapësira luftohej me këmbëngulje për përballimin e mësymjes së forcave kryesore gjermane në çastet më kritike, forcat e tjera të UNÇSH, të ZIOp dhe ato territoriale, me veprime aktive çliruan krahinat e Përmetit, Zagorisë, Lunxhërisë, Pogonit dhe dolën në front të gjerë nga Libohova në Dragot të Tepelenës.

Komanda gjermane, duke mos u pajtuar me gjendjen e forcave të veta që vepronin në Mesaplik-Kurvelesh e Bregdet që kërcënoheshin nga shpina, urdhëroi Div.1 Malor që, me forca të Regj.99 Gjuajtës dhe bat.3Regj.27, të viheshin në gatishmëri për të spastruar rishtas vargun malor në mes të lumenjve Drino e Vjosa. Terreni, vihej detyrë nga komanda eprore të spastruhej nga Veriu në Jug. Në kushtet e epërsisë së armikut, forcat e Br.VIII S si dhe ato të ZIOp dhe bat.3Br. III S, edhe pse përparuan me vështirësi në drejtimet e mësymjes të armikut, ai mundi të dalë në Zagori. Gjithsesi nuk mundi të asgjësonte forcat partizane, spitalet, depot e punëtoritë e ZIOp. Pasi shkelën territoret, forcat gjermane u tërhoqën dhe kaluan në tërësi në Greqinë e Veriut, ku do të merrnin pjesë në një operacion spastrimi në pjesën veriore të saj. Në hapësirën e ZIOp në qendër të objektivit të operacionit u vu krahina e Mallakastrës, e cila u sulmua nga tre drejtime (Sinanaj, Drashovicë nga një kolonë dhe dy kolona nga Fieri) për në thellësi të krahinës së Mallakastrës. Në dispozicion të forcave në operacion u caktuan vetëm tri ditë. Për të dalë në vijat e caktuara, forcat gjermane lëvizën me kolona dhe pa u përpjekur të ndeshen me forcat partizane. Forcat partizane, në kushtet e epërsisë së armikut, manovruan në krahë të forcave gjermane. Në këtë mënyrë forcat partizane nuk u dëmtuan. Me largimin e forcave gjermane ato dolën sërish në rajonet e tyre. Në drejtimin e Sarandës, forca të Br.VI S, në bashkëveprim me forca të ZIOp dhe forcat territoriale, spastruan zonën e Rrëzomës së Delvinës nga mbeturinat e armikut. Po kështu forca të Br.VI S, ZIOp dhanë disa goditje kundër forcave gjermane në rrugën Sarandë-Himarë.

Gjatë të zhvillimit të veprimeve luftarake të forcave gjermane në Kurvelesh-Mesaplik-Bregdet u angazhuan mbi 4.000 forca. Veprimet luftarake aktive të forcave partizane në këtë zonë, si dhe veprimet e mëparshme luftarake të ZIOp që vonuan 10-15 ditë ecurinë e operacionit armik, ishin të një ndihmese të vyer për Komandën e Përgjithshme, për të zgjeruar mësymjen e përgjithshme. Në urdhrin përkatës për D1S të UNÇSH, duke kërkuar të kalohej me shpejtësi në veri të lumit Shkumbin, evidentonte faktin që duhej përfitur nga angazhimi i forcave të shumta gjermane në Kurvelesh. Madje armiku u detyrua të organizonte dhe operacione plotësuese, duke mos lejuar atë të rigruponte forcat në drejtime të tjera.

Herman Frank, oficer gjerman pjesëmarrës në këto luftime, në librin e tij kujton: Forcat partizane mundohen përherë t'i shmangen luftës së hapur ballore kur mbi ta sulmojnë forca superiore gjermane... Ata dinë të mbrohen me zgjuarsi të madhe dhe të dalin nga situata të vështira, sepse i ndihmon njohja e mirë e vendeve.

## 81 VJETORI

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj  
Mjeshtër i Madh

ETAPAT LUFTARAKE TË  
BRIGADËS XV SULMUESE

Operacioni armik i Qershorit 1944 ende vazhdonte në Shqipërinë e Jugut. Mjaft krahina ku zhvilloheshin luftime, si në Opar e në Protopapë më 29 qershor 1944 nisi rrugën luftarake Brigada e XV Sulmuese (Br. XV S). Në inaugurim e sipër brigada vijoi luftimet. Përvoja që kishin fituar kuadrot dhe luftëtarët e batalioneve partizane e territorial të qarkut të Korçës, ishte e dukshme në batalionet "Fuat Babani", "Hakmartje", "Skënder Çaçi", "Reshit Çollaku", "Tomori", "Rinia". E gjithë brigade në momentin e inaugurimit kishte gjithsej 750 luftëtarë. Veprimtaria luftarake e Br. XV S kaloi në disa etapa si në etapën e parë nga 29 qershori deri në 20 shtator 1944, ku zona e veprimeve luftarake ishte fusha e Korçës, rruga automobilistike Voskop-Plloçë, Cangonjë-Pogradec-Qafa e Thanës, qyteti i Pogradecit dhe krahinat Gorë-Oparë. Në etapën e dytë nga 20 shtator deri më 30 shtator 1944, u bë marshimi i saj në rrugëkalimin Veliçan i Mokrës, Polis-Labinot me mision të veprimeve luftarake rruga automobilistike nga Qafa e Thanës deri në Xibrakë. Ndërsa në etapën e tretë e cila nisi më 1 tetori dhe vazhdoi deri më 17 nëntor 1944, ku zona e veprimeve luftarake u bë rruga automobilistike Librazhd-Elbasan-Qafa e Kërrabës dhe qyteti i Elbasanit.

GODITJE TË FORCAVE NAZISTE

Luftimi i parë i ashpër që kreu e gjithë brigada ishte goditja e forcave naziste në rrethinat e Pogradecit, të përqendruara kryesisht në grykën e Pogradecit, në minierën e Çervenakës, në Qafë Thanë dhe në fshatin Çëravë. Forcat naziste ishin të armatosura mirë, të mbrojtur në llogore e fortifikata dhe kishin municion të bollshëm. Por, sulmi partizan bëri që armiku të tërhiqet nga rajoni i Gështenjave, pasi nuk i rezistoi sulmit të rrufeshëm të luftëtarëve. Batalioni i katërt i brigadës më 24 gusht 1944 sulmoi një autokolonë gjermane e cila vinte nga Struga për në drejtim të Elbasanit, ku në rajonin e Qukës, në fshatin Xhyrë, ju bë një pritë e organizuar mjaft mirë. Përpjekja ishte tepër e ashpër, pasi dhe një autokolonë nga Elbasani i vjen në ndihmë forcave të ardhura nga Struga. Kështu që u godit njëkohësisht, pasi masat organizative ishin marrë më parë dhe luftëtarët kishin zënë pozicione kyçe të terrenit. Në pritë e cila vazhdoi dhe luftim trup me trup armiku pësoi dëme si në njerëz dhe në materiale. Mjaft makina dolën jashtë

# Brigada XV Sulmuese u pagëzua në Operacionin e Qershorit 1944



Shahin Ruka

Teki Kolaneci

gatishmërisë si dhe u ka shumë municion. Në këtë aksion u kapën dhe mjaft dokumente gjermane. Më 30 gusht, forcat e Br. XV S hynë në Pogradec dhe të gjitha fshatrat buzë rrugës automobilistike nga Lini deri në Podgorie ishin të çliruara. Natën e 24 shtatorit, forcat e batalionit të dytë dhe të tretë goditën një autokolonë që vinte nga Struga për në Elbasan i asgjësuar dhe shkatërruar plotësisht. Nazistëve gjermanë ju kapën sasi të madha me armë dhe municione, por dhe pati humbje në njerëz. Ditë më vonë Br. XV S kaloi lumin Shkumbin dhe u vendos në rajonin e Elbasanit, ku kreu disa goditje kundër forcave naziste. Shtabi i brigadës bëri përgatitjet e duhura, siguroi krahët dhe bëri planin luftarak për të sulmuar dhe çliruar qytetin e Elbasanit, ku ishin strehuar mbi 2.500 ushtarë e oficerë të nazist. Për çlirimin e qytetit sulmi filloi mbi objektin kryesor që ishte Ura e Zaranikës, lagjja e Kishës dhe kazemat e Krastës. Batalioni i katërt veprimet luftarake i përqendroi në mbulimin e krahëve dhe sulmoi forcat armike njëkohësisht në Xibrakë dhe Labinot. Batalioni i dytë kishte për detyrë të pengonte lëvizjen e armikut në rrugën Elbasan-Tiranë. Sulmi filloi më 5 nëntor dhe pas dy ditë me

luftime, batalioni i katërt paralizoi forcat e armikut në fortifikatat e vendosur në Xibrakë dhe në Labinot.

BRIGADË E PËRGATITUR PËR  
LUFTIME NË QYTET

Në të njëjtën kohë, forcat e batalionit të parë dhe të tretë, përparuan me luftime në drejtimet e parashikuara, duke bërë që qyteti i Elbasanit të rrethohej plotësisht prej tyre. Forcat armike u përqendruan në rrethinat e Shkollës Normale. Forcat e brigadës organizuan një sulm të shpejt, duke njohur vendin, rrugët dhe shtëpitë rezistuese, e detyruan armikun të linte dhe qëndresën e fundit, duke u larguar në mënyrë të çrregullt në drejtim të Tiranës. Forcat naziste në udhëtimin e tyre për në Tiranë pësuan goditje nga forcat partizane që kishin zënë pritë në Bradashesh dhe në lartësitë e Qafës së Kërrabës. Më më 15 nëntor 1944 Elbasani e çlirua. Partizanët e brigadës kryen dhe detyra të tjera në interes të luftimeve të përgjithshme, duke mbajtur në goditje të vazhdueshme trupat naziste në rrugën Elbasan-Qafa e Kërrabës dhe mori pjesë në çlirimin e Tiranës. Nga brigade ranë dëshmorë të atdheut 50 luftëtarë. Shumë prej tyre ishin kuadro si Istref Maka, Koço Boboshtica, Minosh Gjoka, Rahman Beragishti, Thomaidha Laçka dhe Shaniko Starja, etj. Gjatë luftimeve luftarake Br. XV S çliroi një sipërfaqe prej afro 4000 km katrorë nga forcat reaksionare, shpartalloi dhe çarmatosi mbi 2.000 forca xhandaro-balliste në fushën e Korçës dhe në Zonën e Qukësit, zuri 72 rob gjermanë, dogji e shkatërroi mbi 200 makina të ndryshme të pushtuesit dhe kapi mjaft dokumente të rëndësishme ushtarake të pushtuesit, etj.

ROLI I KUADROVE DREJTUES

Një rol dhe veprimtari të rëndësishme në veprimtarinë luftarake të Br. XV S luajtën komandant Teki Kolaneci, Hero i Popullit dhe komisar Shahin Ruka. Në brigadë luftuan dhe drejtuan dhe kuadro të tjerë drejtues si Meço Starja, Maço Çomo, Arzen Leskoviku, Llazi Stratobërdha e Endri Keko etj. Br. XV S përshkroi një faqe të lavdishme dhe si gjithë brigadat e tjera të UNÇSH, u bë tmerr për armikun dhe shpresë për popullin. Armiqtë dhe tradhtarët

nuk e ndjenë asnjëherë veten të qetë, si në fortifikata apo në fushat e betejave si në Pogradec, Qafë Thanë, Librazhd, Mirakë, Xibrakë, Labinot, Elbasan dhe deri në Qafë Kërrabë, në afërsi të Tiranës. Më 18 nëntor 1944 brigada u rreshtua në Divizionin I Sulmues dhe u përqendrua në grykën e Delvinës me detyrë për mbrojtjen e kufirit shtetëror. Në këtë kohë brigade kishte rreth 1.200 luftëtarë. Populli i krahinave të Korçës, Pogradecit, Librazhdit dhe Elbasanit i kujtojnë me admirim dhe respekt heroizmat dhe trimëritë e partizanëve të kësaj brigade në këtë 81 vjetor të krijimit të saj. Përmendoret, lapidarët dhe pllakate përkujtimore të ngritura në vendet ku u kryen luftime dhe aksione, flasin për guximin, për trimërinë e luftëtarëve, komandantëve dhe komisarëve të kësaj njësie lavdi madhe. Kujtimi dhe respekti për dëshmorët e kësaj brigade kanë mbetur pishtar në rrugën e demokracisë të Shqipërisë dhe të popullit.

KOMANDANT, TEKI KOLANECI

Teki Kolaneci lindi në vitin 1913 në fshatin Kolanec të rrethit të Korçës në një familje atdhetare. Luftoi dhe veprroi kundër regjimit të Zogut. Mori pjesë në kryengritjen e Fierit 1935, ku u arrestua dhe u dënua me 15 vjet burg. Gjatë LANÇ-it u shqua si luftëtar dhe udhëheqës ushtarak. Ishte ndër partizanët e parë në rrethin e Korçës, komandant i çetës së Gorë-Oparit në vitin 1942. Me formimin e Br. XV S u emërua komandant i saj. Komandant Tekiu ishte njeri i veprimit, aksionit dhe kudo në luftime drejtoi me kompetencë dhe kishte përgatitje të mirë ushtarake. Shquhej për nismë dhe aksione të guximshme. Pas çlirimit të vendit ka pas funksione të rëndësishme deri në zëvendësministër i Punëve të Brendshme. Mbante titullin e lartë "Heroi i Popullit" dhe mjaft dekorata të tjera.

KOMISAR, SHAHIN RUKAJ

Shahin Rukaj, lindur më 4 prill 1918, në fshatin Matogji të rrethit Vlorë. Mësimet e para të fillores i mori në qytetin e Fierit dhe në vitet 1932-1940 kreu shkollën Teknike në Tiranë. U lidh me Lëvizjen Antifashiste, duke marrë pjesë në aksionet e njësiteve guerile të qytetit të Tiranës. Komiteti qarkor i Tiranës gjatë vitit 1943 e kishte ngarkuar me detyrat ushtarake.

Në tetor 1943 u emërua komisar politik i Br. II S deri në maj 1944. U emërua komisar politik i Br. XV S deri në çlirimin e vendit. Mbante gradën ushtarake Major. Në dhjetor 1944 emërohet në Ministrinë e Punëve Botore, inspektor. Në vitin 1946 u ngarkua me organizimin e administratës shtetërore të transportit automobilistik të Republikës. Kreu Universitetin e Moskës, në Fakultetin Ekonomi Politike në vitin 1960. Në vitet 1948-1982, ka kryer detyrën e zëvendësministrit të Ministrisë së Ndërtimit, të Ministrisë Miniera-Gjeologji etj. Ka qenë dhe përfaqësues i përhershëm në Këshillin Ekonomik të Ndhmës Reciproke (KNER) në Moskë dhe së fundi në aparatit e Këshillit të Ministrave, si këshilltar. Dekoruar me urdhra dhe medalje. Mban dy medalje të Republikës Ruse, të "50 vjetori i fitores së Luftës së Madhe Patriotike" dhe medaljen "Zhukov".



## PROMOVIMI

Libri "Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave" me autor Halil Rama – Mjeshtër i madh, promovohet në Radio Kosova e lirë

# Libri i Halil Ramës, pikë reference për brezat e ardhëshëm

**TEFTA CAMI-CANI**  
**Ish-Ministre e Arsimit dhe**  
**Kulturës**

Shpreh kënaqësinë, që mora pjesë me datën 12 prill, 2025 në promovimin e librit të 28 të Mjeshtër të Madh, z. Halil Rama me titull "Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave" tek Kinema "Maks Velo" në Laprakë të Tiranës.

Përgëzoi z. Halil Rama për këtë botim të rëndësishëm, që do të mbetet një pikë reference për brezat e ardhëshëm.

Më vjen mirë, që ka shumë prodhime e botime nga mjaft dibranë ashtu si dhe nga e gjithë Shqipëria e diaspora, si në fushën e letërsisë e arteve, të historisë e arkeologjisë, të publicistikës që, i përgëzoi dhe ju uroj suksese dhe dëshiroj të realizojnë sa më shumë krijimtari në shërbim të mëmëdheut e të kombit shqiptarë!

Në atë promovim kishte një pjesëmarrje të gjërë me dibranë, kryesisht, të pjestarëve e të famijarëve, që janë përshkruar në këtë botim siç mora pjesë edhe unë.

U organizua dhe u realizua një përshkrim i librit nga disa studiues, si nga profesor Bernard Zotaj e të tjerë, që referuan në auditor për kriteret e përzgjedhjes të disa dibranëve në panteonin e vlerave, për klasifikimin e tyre sipas profileve, për përmbajtjen e kontributeve të disa prej atyre personazheve, që përshkruhen në libër, si dhe për metodën e stilit dhe gjuhën e pasur, që ka përdorur autori.

Kanë shkruar e botuar libra të tillë edhe nga disa autorë të tjerë dibranë, që kanë përshkruar disa figura të shquara dibrane të fushave të ndryshme ndër vite.

Kushdo që bën përzgjedhjen e figurave të shquara të të gjitha fushave, me siguri, e bëjnë me studime e konsulta të gjëra me specialistët e fushave përkatëse dhe mbi ato studime kanë bërë vlerësime reale të kontributeve të tyre duke u udhëhequr nga kriteri i vlerave, që kanë punuar me nivel e cilësi në interes të mëmëdheut e të kombit shqiptarë deri në fund të jetës së tyre!

Një botim të këtij lloji ka bërë profesor Hajri Shehu për disa personalitete shkencore e publicistike dhe politike e kulturore në shkallë kombëtare, që u përmbahet kriterëve kryesore. Ai i ka studiuar kontributet me vlerë të tyre. Edhe z. Aqif Ademi ka shkruar e botuar një libër për disa dibranë të shquara të fushave të ndryshme.

Falenderoj z. Halil Rama që në këtë botim ka përshkruar për:

- "Babain tim, Ahmet Feta Cami, që ka krijuar çetën e parë antifashiste që në janar 1940 dhe ka bërë dy aksione në fund të marsit dhe me 2-3 prill të vitit 1941 që, për këtë shkak, u futën në pushkatim 8 vetë (7 Cami), u futën në vranë, ndërsa të tjerët u larguan meqë ishin të palidhur e natën.

U futën në burg 19 burra e djem Cami me komandantin e tyre, Ahmet Cami. Janë faksimilet e tyre në Arkivin e MPB të atyre viteve. Kjo çetë del, se ka qenë si çetë e parë atdhetare e krijuar në Shqipëri gjatë LANÇ. Prandaj edhe historia e LANÇ duhet të rishkruhet dhe të plotësohet me dokumentet e

të plotë të nxënësve dhe studentëve të ardhëshëm.

Gjithmonë modelet e para duhen evidentuar e përshkruar, sepse janë ata që përballojnë të parët vështirësitë dhe janë shembuj për të tjerët.

Në jetë modelet e tilla brenda e jashtë Shqipërisë dhe në Diasporë



duhura, si dhe duke evituar subjektivizmat e glorifikimet dhe përvetësimet e luftës të të tjerëve e pasaktësitë.

-Bashkëshortin tim, dr. Mahdi Cani-misionarë i mjekësisë shqiptare, që ka kuruar e shëruar pacientë me të prekur me duar me anë të energjisë që dispononte. Nga pacientë thuhet: "dr. Mehdiu shëron edhe me fjalë!" Ai ka vizituar falas gjatë gjithë karrierës si mjek, si dhe ka ndihmuar shumë pacientë në nevojë, me gjithë kushtet e vështira ekonomike që kishte në familje.

Ky shekull është shekulli i bioenergjisë, ku do të vihet në përdorim bioenergja në të gjitha fushat, sidomos në fushën e mjekësisë për shërimin e të sëmurëve që, me siguri, MSHS, e ka organizuar për t'u zbatuar me prioritet bioenergja.

-Ka shkruar për vajzën time prof. dr. Alma Cani, drejtoreshë e QSUT, dhe për mua, si dhe për disa kushërinj."

Shpreh kënaqësinë, që z. Halil Rama, si dhe autorët e botimeve të lartpërmendura, përshkruajnë modelet të shquara të disa personazheve të fushave të ndryshme, siç përmendet edhe gjeneralmajorja e parë e Forcave të Armatosura Shqiptare, znj. Manushaqe Shehu, që është bërë model për të tjerët. Në vitin 1976, kur u emrova ministre e Arsimit dhe Kulturës përveç dhënies të lëndëve të kulturës ushtarake me cilësi, programuam në Shkollat Ushtarake dhe të Policisë futjen edhe të lëndëve të kulturës së përgjithshme, që ndikoi në formimin më

janë të shumtë. Publikimi i modeleve shembullore të të gjitha fushave, krijuarë mundësi për edukimin e brezave të rinj, që ta nisin jetën e tyre në mënyrë të shëndetëshme dhe të mendojnë e kontribuojnë për përparimin e mëmëdheut drejt progresit.

Drejtimesit e çdo fushe e sektori do të jenë të suksesëshëm në drejtimin e sektorëve të tyre, nëse tek vartësit do të evidentojnë vlerat e shquara të tyre dhe t'ju japin projekte e udhëzimet e nevojshme me profesionalizëm, duke u dhenë besim e siguri për realizimet e tyre. Në të kundërt, marrja me cingërima e informata të fshehta e përdorimin e një fjalori të rëndomtë e dhunues ndaj vartësve, duke i keqtrajtuar, cënon bashëpunimin epror-vartës, i deprimon punonjësit, nxit urrejtjen dhe dëmton realizimin e projekteve të rëndësishme.

Është shkruar për strategun e udhëheqësin kombëtarë e ndërkom-bëtarë të arbërit dhe të lufrave kundër osmanllinjve për çerek shekulli, Skënderbeun. Për biografinë e Skënderbeut ka shkruar historiani humanist dhe meshtari Dhimitër Frangu, që ka qenë luftëtarë e historian i ,biografisë të parë për heroin e arbërit, Skënderbeun në shekullin XV. Në shekujt XV-XVI ka shkruar historiani Marin Bartletti për biografinë e Skënderbeut dhe rrethimin e Shkodrës. Për biografinë e Skënderbeut e lufrat e tij kanë shkruar edhe Rilindësit tanë në shekullin XIX, si dhe shumë historianë botërorë. ASHSH është marrë për të studiuar

• **Evidentimi i vlerave të shqiptarëve të të gjitha fushave dhe të gjitha periudhave të historisë shqiptare, është mision i çdo studiuesi**

jetën e heroit tonë kombëtarë Skënderbeut si profesor Kristo Frashëri e Stefanaq Pollo e të tjerë.

Me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë është zhvilluar në Tiranë në vitin 1968 Konferenca Shkencore "Heroi Kombëtarë, Skënderbeu dhe Epoka e tij", ku kanë marrë pjesë e kanë referuar studiues shqiptarë e të huaj. Kanë marrë pjesë edhe studiues nga Kosova dhe Arbëreshë të Italisë e të Zarës të Kroacisë.

Është prodhuar nga Kinostudio "Shqipëria e Re" dhe "Moskfilm" filmi për Skënderbeun, që është shfaqur për herë të parë në vitin 1954, si dhe opera "Skënderbeu". Në vitin 1959 është përvuar monumenti i Skënderbeut në Krujë. Ky monument ishte vepër e skulptorëve të shquar Odhise Paskali, Andrea Mano, Janaq Paço. Sipas informacioneve në internet filmi e opera si dhe monumentet për Skënderbeun janë krijuar me kërkesën e me porosi të Enver Hoxhës.

Është ngritur përmendore e Skënderbeut me shpatë dhe mbi kalë në Tiranë me 11 janar, 1968, që është vepër e skulptorëve të popullit shqiptarë : Odhise Paskali, Andrea Mano dhe Janaq Paço. Monumenti është derdhur në bronz në Itali. Është ngritur monument edhe në një shesh të Romës në vitin 1968 nga Qeveria Italiane dhe i kanë vënë emrin sheshit "Sheshi Skënderbe".

(Vijon në faqen 9)

PORTRETE

Dëshmorë të Atdheut (të pashpallur) Shtator, 1796

# ZEQIR AGË PUKA dhe IBRAHIM KURTI

**Z**eqir Agë Puka ishte shpërngul prej Kabashit dhe ishte vendosur në Pukë, në Kodër Laçaj, ku toka ishte e pakët e me konflikte me Laçajt, të cilët prej kohësh ishin atje. Në këto rrethana i forcoi lidhjet me Karamahmut Pashë Bushatin, i cili e ndihmoi të vendoset në Zadrimë në tokë të mjaftueshme, por të ishte i gatshëm për t'iu gjet K. Pashës Bushatli. Zeqir Agë Puka iu përgjegj çdo herë me besnikëri bashkë me miqtë e përkrahësit e tij, si edhe Ibrahim Kurti prej Micoj. Kështu iu përgjegj edhe në thirrjen e bërë në shtator 1796 për hakmarrjen kundër Malit të Zi, ku forcat e K. Pashës kishin pësuar disfatë, (3 batalonet e tij gjatë përpjekjeve për të hyrë në thellësi të Cernagores drejt Cetinës, që cënonte tokat tona Arbërore). Por edhe kësaj herë ra në kurthin që i kishin ngritur armata e tij bashkë me forcat malazeze. Kështu një natë, me 22 shtator 1796, me shtërngatë shiu u rrethua nga trupat malazeze dhe përkrahësit e tyre nga radhët e fshatrave shqiptare (të Kuçit, të Piprit dhe Palabardhit). Nga koha e keqe e sulmi i furishëm malazez çadra e K.Pashës mbeti e pa mbrojtur, ku hynë armiqtë. Ata vranë Pashën dhe i këputen kokën, të cilën e vëndosën në Muzeun e Cetinës, si krenari e fitorës së tyre.

Zeqir Agë Puka bashkë me Ibrahim Kurtin dhe trimat e tyre bënë një qëndresë heroike në hakmarrje të Karamahmut Pashës duke mos kursyer as jetën. Prandaj populli i Pukës e i Shkodrës i ka kujtuar për besnikërinë e guximin e tyre, deri në ditët tona.

Imam Shaban Hoxha i Lejthizës, hoxhë e mësues në fshatin Micoj, në vitet 1920-1930 ("Kabashi", Tiranë, 2008, fq.118) na tregon se:

"Zeqir Agë Puka - burrë Kreshnik, guximtar e besnik, / Hidhet në luftë e hidhet n'zjarr / Për ta pshtu Pashën të gjallë / Fill mbas Tij Ibrahim Kurti prej Micoj, / Sikur t'kishte krahë dragoj! / N'zjarr të luftës pa u dal / Der sa Dëshmor ata kanë ra! / Fill mbas tyne si rrufe! / Cani i Llesh Dedës bajraktar / Në sulm me Dushsit pa u nal / U vranë trimat e Bajrakut se s'ju tremen




XHEMAL MEÇI  
Studiues, "Mjeshtër i Madh",



Karadakut! ( Pukë, 2008, vargje kënge nga Fadil Ceni, gazetar)

**KARA MAHMUD PASHA**  
(Një mik i Zeqir Agë Puka)  
Shkodër, 1749- Kruis, 22.09.1796

Kara Mahmud Pasha ka lindur 1749 në Shkodër, djali i dytë




Mehmed pashë Plakut. Sipas Dom Ndoc Nikajt i bie të ketë qenë i pari. Iku herët nga shtëpia - sipas konsujve Hahn e Hecquard - për arsye se kishte vranë qehajain e të atit, Myrteza efendiun, sepse kishte shkelur besimin e mytesarifit dhe kishte përvetësuar. Shkoi në Stamboll, ku i përkrahur nga autoritetet shtetërore u shkollua në "Enderün-i Hümayün" (Shkolla Mbretërore e Brendshme). Rezultatet e larta të arritura dhe aftësitë që shfaqti, e shtynë Portën e Lartë së bashku me parinë e qytetit që të ndërmjetësonin pranë Mehmet pashë Plakut për falje.

Më pas u emërua kajmekam i Shkodrës e pastaj allajbej, u bë pashë në moshën 18-20 vjeçare si shpërbllim për trimërinë që tregoi në shtypjen e rebelimit grek në Morë në kohën e Luftës Ruso-Turke. Mbështetur në arkivin e Venedikut, autori Stavri Naçi si vit të zyrtarizimit të Kara Mahmudit jep vitin 1778.

Prej shërbimeve të bëra, më 1783 i vëllai Ahmet Pasha, u emërua mytesarif i Ohrit.

Në shkurt të 1785 largoi dizdarin e kalasë së Shpuzës, vuri të paguanin haraçin e papaguar që nga kryengritja e 1775-1776 dhe hapi puse në Cetinë



që nuk kishte ujë. Pasi shtroi fiset e malësisë malazeze, doli nga Adriatiku.

Sami Frashëri te Kâmûs al-Alâm e përshkruan "Meçë ishte shumë trim dhe i zoti, i kreu mbretërisë shumë shërbime", më pas u ndikua nga Austria e Venediku dhe pasi e kuptoi që këta vende nuk e kishin në të mirë të botës muslimane, vrau të dërguarit të Austrisë dhe ia dërgoi Portës letrat e dhuratat e sjella prej tyre.

Sipas Eqrem bej Vlorës, ishte i pari ndër sanxhak-bejlerët shqiptarë që u ngrit hapur kundër pushtetit qendror.

Noel Malcolm e përshkruan Kara Mahmud Pashën si "njeri të jashtëzakonshëm" që fatkeqësisht ka gëzuar shumë pak vëmendje në Perëndim, në krahasim me bashkëkohësin e tij toskë nga Janina, Ali Pashë Tepelenën, 'Luanin e Janinës' më Pas shtrimit të malazezëve në haraç pas viteve mospagesë, çeli në Cetinë shtatë puse që ende quhen "Puset e Kara Mahmudit"

Ndre Mjedja i kushtoi poezinë Mahmud Pasha në Mal të Zi. Anton Harapi ka lënë në dorëshkrim veprën Karagega, që mendohet si triptik i veprave Valë mbi valë dhe Andrra e Prëtashit.

Një tjetër françeskan, Zef Pllumi në veprën Frati i pashallarëve Bushatli të Shkodrës: At Erasmo Balneo riprodhon një kronikë të lexuar në arkivin e Kuvendit Françeskan para se të sekuestrohet dhe plaçketej nga regjimi komunist.

Kronika, sipas Pllumit, shkruhet nga një françeskan që u bë mjeku, mësuesi dhe këshilltari i Kara Mahmud Pashës.

(Marrë nga interneti)

## Libri i Halil Ramës, pikë reference për brezat e ardhëshëm

(Vijon nga faqja 8)

Në vitin 1968 është prodhuar e vënë në skenë Opera e parë për Skënderbeun në Shqipëri me muzikë të kompozitorit të shquar Prenk Jakova.

Vitet e fundit janë ngritur përmendore për Skënderbeun në disa vende të tjera shqiptare, si në Kosovë e Dibër të Madhe, në Malësinë e Madhe, tek Arbëreshë e Italisë dhe në Zarë të Kroacisë, në Detroit të SHBA, si dhe buste në disa qytete të Europës e vende të tjera. Në botimin e z. Halil citohen edhe autorë dibranë, që janë marrë me studime për Skënderbeun dhe kanë bërë edhe botime si profesor Fatos Daci dhe profesor Besnik Kebej e të tjerë.

Z..Besnik Kebej ka qenë drejtori i parë i Muzeut të Kastriotëve dhe Skënderbeut, që kemi ndërtuar si MAK dhe përruar në Sinë të Dibrës me 12 shtator, 1982.

Gjatë përrurimit kemi qenë të pranishëm si, prof. Aleks Buda, kryetari i ASHSH, prof. Stefanaq Pollo, drejtori i Institutit të Historisë të ASHSH,

prof. Kristo Frashëri, që kishte studiuar e botuar për Skënderbeun, z.Skënder Dema, kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të rrethit të Dibërës, z.Hysen Lala, drejtor i Muzeut Historik të rrethit të Dibërës. Kam marrë pjesë edhe unë si ministre e Arsimit dhe Kulturës dhe të tjerë. Në AQSH kam lexuar informacione të Byrove të Komiteteve të Partisë të rrethëve të Kukësit dhe të Krujës, që i çonin Enver Hoxhës me këtë përmbajtje: "Ministrja e Arsimit dhe Kulturës, Tefta Cami, e ka nxjerrë Skënderbeun nga Dibra". Në informacione shkruhet, se Skënderbeu ishte nga Hasi i Kukësit, apo nga Kruja. Enveri ka shënuar: "Nuk e ka përcaktua ministrja, por historianët." Në ato vite pushtetarët e drejtuesit e tjerë kontrolloheshin nga organet qendrore dhe të bazës.

Është meritë e z.Besnik Kebej, që ka studiuar e ka bërë gërmime arkeologjike për vendin e qytetit e Gjon Kastriotit dhe të Skënderbeut. Ai ka ruajtur e mbrojtur objektet e Muzeut në Sinë të Dibrës dhe nuk

lejoi të asgjësohet Muzeu, ashtu siç u prishën të gjitha muzetë historik në Shqipëri gjatë viteve 1990-1998. Kebej meriton përgëzime e vlerësime dhe dekorime.

Një popull që nuk njeh historinë e paraardhësve të tij, është pa të ardhme dhe është i destinuar të zhduket.

Historiani nga Kosova, dr. Mark Palnikaj ka studiuar në Arkivin Sekret të Vatikanit dokumente për Skënderbeun dhe, siç është publikuar në youtube, në Arkivin e Vatikanit janë 445 km. dosje vetëm për Skënderbeun. Ka mjaft studisë të apasionuar, që janë marrë e merren me studime historike për periudha të caktuara të historisë tonë. Studimet në fushën e historisë të periudhës së Skënderbeut dhe të periudhave të tjera të historisë lind nevoja të organizohen e drejtohen nga ana e ASHSH dhe ASHA të Kosovës me grupe të mëdha, duke u mbështetur me fonde të nevojshme nga Ministria e Ekonomisë dhe Kulturës, si dhe nga biznesmenë.



Fillimi / Opinione / Tefta Cami-Cani: Evidentimi i vlerave të shqiptarëve të të gjitha fushave dhe të gjitha periudhave të historisë shqiptare, është mision i çdo studiuesi



**TEFTA CAMI-CANI: EVIDENTIMI I VLERAVE TË SHQIPTARËVE TË TË GJITHA FUSHAVE DHE TË GJITHA PERIUDHAVE TË HISTORISË SHQIPTARE, ËSHTË MISION I ÇDO STUDIUESI**

## HOMAZH

# BASHKIM DUMANI NUK U JOSH NGA PASURIA, POR NGA DIJA E SHKENCA

• *Bashkim Dumani prodhoi verën "MERLOT", e cila fitoi Medalje Ari në Konkursin Kombëtar të Verërave të organizuar në vitin 1970 në Tiranë nga Ministria e Bujqësisë. Po këtë vit fitoi Medalje Ari në Konkursin Ndërkombëtar të mbajtur në Bukuresht të Rumanisë.*

## FAIK XHANI-Mjeshtër i Madh

**E**njoja në rininë e tij. Ishte i gjallë me tërë energji. Fliste pak dhe punonte shumë. Ishte këmbëngulës dhe vullnetfortë. Kishte etje të madhe për dije dhe kërkim shkencor.

Lindi në një familje me gen pune dhe menaxhimi, me 16 qershor 1950 në Shtushaj të Dibrës, sot pjesë e Bashkisë Bulqizë.

Quhej Bashkim Hysni Dumani. Mësimet e para e shtatëvjeçaren i mori në vendlindje. Dhe Bashkimi ishte krenar që po i shtonte vendlindjes dhe Dibrës teknologun ushqimor, që në atë kohë numëroheshin me gishta. Nisi me pasion punën si specialist në sektorin e prodhimit të distilatave të alkolit të esencave në Ndërmarrjen Industriale Ushqimore Peshkopi. Në këtë ndërmarrje që gumëzhinte nga qindra punëtorë e veçanërisht nga vajzat e gratë që punonin si bletë punëtoresh dhe ndrisnin muzaikun e këndshëm të qytetit të bukur të Peshkopisë. Bashkim Dumani, djali serioz me moral kristal, krahas punës në ndërmarrje, ndiqte kërkimin shkencor për zhvillimin e frutikulturës që ti përgjigjej sa më mirë nevojave të furnizimit të asaj ndërmarrje. Ai studim i kushtoi teknologut Dumani 25 vite të jetës së tij.


Pasioni për studimin dhe aplikimin e arritjeve e përvojave më të mira të vendit e më gjerë e shoqëroi tërë jetën teknologun dhe arritjet nuk munguan.

Bashkim Dumani prodhoi verën "MERLOT", e cila fitoi Medalje Ari në Konkursin Kombëtar të Verërave të organizuar në vitin 1970 në Tiranë nga Ministria e Bujqësisë. Po këtë vit fitoi Medalje Ari në Konkursin Ndërkombëtar të mbajtur në Bukuresht të Rumanisë.

Këto arritje ia shtuan pasionin Bashkimit për studime, kërkime dhe aplikimin e teknologjive të reja bashkëkohore, ia përkëdhelën sedrën dhe krenarinë, por nuk ia rritën mendjen. Ai sa më shumë kalonte koha nuk u mjaftua me ç'ka kishte arritur, përkundrazi u përqëndrua gjithnjë e më shumë në studime e aplikimin e teknologjive të reja.

Pas mbarimit të shërbimit ushtarak u rikthye përsëri në Ndërmarrjen Ushqimore Peshkopi. Për gjashtë vite me radhë në këtë ndërmarrje kreu detyrën e specialistit, kontrollorit të cilësisë e deri drejtor, duke e bërë atë nga më të dalluarat në shkallë Republike. Gjithmonë në kërkim të përvojave më të mira e teknologjive të reja ushqimore edhe në rajon e Europë.

Ishte viti 1979 kur Bashkim Dumani filloi punë si specialist në sektorin e verërave, pijeve alkolike, birrës në Institutin e Kërkimeve të Ushqimit pranë Ministrisë së Industrisë Tiranë, detyrë të cilën e kreu më së miri. I motivuar plotësisht, Bashkimi dha ndihmesën e tij në studimin e projektimit e Fabrikës së Pijeve Alkolike Peshkopi, por edhe te 12 fabrikave të tjera në vend që



u ngritën gjatë periudhës 1982-1988. Për tetë vjet Bashkim Dumani kreu detyrën "Kontrollor Cilësie" (kualiteti) e sasië (kuantiteti) i prodhimit të konjakut, pijeve alkolike, freskuese, esencave për Industrinë Ushqimore, lëngjeve të frutave, verërave e distilateve të alkolit të prodhuara në Kombinatin Ushqimor "Ali Këlmendi". Etja për dije nuk iu shua kurrë Bashkimit.

Kreu studimet e larta në Universitetin e Tiranës, dega industri ushqimore. Mbron temën dhe laurohet në fushën e Entologjise. Fiton titullin "Kimist-biolog". Po ashtu kreu studimet pasuniversitare (SPU) pa shkëputje nga puna dhe diplomohet me mbrojtje teme.

Në vitin 1990 fiton titullin "Kandidat Shkencash". Studioi edhe për kimi ushqimore. Krahas përgatitjes dhe formimit profesional Bashkim Dumani kreu me nder një sërë detyrash në shkallë vendi e më gjerë. Per gati katër vite kreu detyrën e "Kryekontrollorit" në Qendrën e Referencës dhe Kontrollit Ushqimor në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit për prodhimet ushqimore dhe farmaceutike të prodhuara në vend për konsum në tregun e brendshëm e për eksport dhe për produktet e importit.

Gjate periudhës dyvjeçare 1993-1995 ai mbajti detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Bordit Kombëtar të Kontrollit të Ushqimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Kreu detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Financiare pranë Ministrisë së Financave. Për tre vite 1994-1997 qe përfaqësues Zyrtar i Shqipërisë në Komunitetin Europian me seli në Bruksel dhe pranë Organizatës Botërore të Ushqimit (FAO) me seli në Romë.

Qe anëtar i Këshillit Shkencor të Institutit të Kërkimeve të Ushqimit dhe Bujqësisë Tiranë. Gjatë viteve 1995-1998 Bashkim Dumani kreu detyrën zv/ Drejtorit të Përgjithshëm, shef i departamentit Teknik dhe më vonë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kontrollit të Ushqimit në Ministrinë e Bujqësisë. Ketu, ai demonstroi cilesitë më të larta të nëpunësit shtetëror me përgatitjen

e lartë profesionale, i pakomprometueshëm dhe me përgjegjësinë e lartë për garantimin e cilësisë së produkteve ushqimore për popullatën shqiptare.

Në këto detyra të larta dhe me përgjegjësi Bashkimi provoi dhe joshjet për t'u pasuruar. Disa herë i serviren çanta me para që të mbyllte sytë e gojën, por ai nuk u thye e nuk u dorëzua. Jo rrallë pati dhe presione, shantazhe e kërcënime, por nuk u përku. Vërtetë nuk u pasurua, por shëndriti si nëpunës me integritet të lartë dhe i dha emër jo vetëm vehtes, por edhe Shqipërisë e shqiptarëve.

Gjatë dy viteve bashkëpunoi me ekspertë italianë në fushën e prodhimit të produkteve ushqimore të gatshme në Romë Itali. Po kështu për shtatë vjet bashkëpunoi në fushën e prodhimit të Litografisë "Multiprint" në Romë dhe po shtatë vjet të tjera dha ndihmesën e tij në programimin, prodhimin, montimin e testimin e aparaturave elektronike dixhidale për përdorim në industri duke lënë një emër të nderuar si shqiptar.

Me 20 Mars 2025 zemra e Bashkim Dumanit pushoi së rrahuri njëherë e përgjithmonë në Vienë të Austrisë. Kjo ndarje e papritur nga jeta e tij hidhëroi jo vetëm zemrat e familjarëve, gjakut e gjinisë, por e të gjithë atyre që e njohën dhe punuan me të. Iu bënë të gjitha nderimet gjatë ceremonisë së lamtumirës në Vienë të Austrisë.

Por nipi i tij Armando Dumani, së bashku me dy vajzat e Bashkimit, me 13 Prill organizuan një ceremoni kujtese te lokal "Ija" në Tiranë ku morën pjesë shumë vendlindas që kujtuan dhe e nderuan jetën dhe veprimtarinë e Bashkimit. Ai me detyrat që ka kryer mund të ishte bërë një nga më të pasurit e Shqipërisë, por nuk u pajtua me korrupsionin. Bashkim Dumani, kudo që shërbeu e punoi dha gjithçka nga vetja për Shqipërinë dhe shqiptarët. Sa shumë kemi nevojë për të tillë nëpunës e intelektualë me ndershmëri e integritet, kur presim të bëhemi pjesë e familjes progresiste Europiane!

## SKICË

# Kryefamiljari model Qemal Ramadan Zeqaj

## Zef Rrozhani

Para disa ditësh, ndoqa me vëmendje përrurimin e njëzetetë të botimit të shkrimtarit dhe gazetarit të talentuar Halil Rama. Gjithmonë i kam ndjekur me kënaqësi këto evente dhe i kam përjetuar si gëzim i veçantë. Por ajo që më bën të shkruaj këto radhë është pjemarrja e madhe e intelektualëve.

Shkrimtari Halil Rama, ka arritur të na japë me vërtetësi jetën e larmishme njerzore, protoganizmin e gjallë të vlerave të këtij kombi të pa epur. Në të gjithë personazhet e një morie librash, shpaloset dimensionin e dashurisë për atdheun, familjen e shoqërinë.

\*\*\*

Para disa vitesh pata botuar një artikull me titull "Një

djalë si Endri Zeqaj". Si një njeri gjysëm shekullor i letrave, personazhe të veçantë më kanë frymëzuar ti përshkruaj në faqet e gazetave. Këtë ndjesi e di me siguri që e ka edhe miku im autori i njëzetetë të librave. Pra këto njerëz i japin jetë, jetës, bëjnë atë të ndjehet fuqishëm.

Endri Zeqon e njoha në klinikën Dentare "Mat-Dental", të Profesor Doktor Sali Kurtit, "Mjeshtër i madh" i cili ka mbi 5 dekada në këtë profesion. Në atë klinike në zemër të Tiranës, bien në sy mjekë të rinj që Profesor i ka zgjedhur nga "Fidanishtja" e stomatologjisë. E ndër ato bie në sy një djalë i ri nga Dyshniku i Beratit. I dashuruar pas këtij profesioni ai nën vëzhgimin e mprehtë të profesorit u bë i aftë. Qemal Zeqaj, gjyshi i mjekut të ri i kishte dhënë të nipit një porosi të veçantë! Me që Zoti të ka dërguar të punosh në klinikën e një

(Vijon në faqen 11)

## PROFILI

# PËR VETERANIN E KUFIRIT LENIN MARK NDRECA

Nga Mevlud BUCI

Dy vjet më parë, në Akademinë e Shkencave u promovua libri monografik për Mark Ndrec Vladin e Lurës.

Prof. dr. akademik Shaban Sinani vlerëson se: "Figura e Mark Ndrecë Vladit, me historinë e origjinës, të lidhjeve familjare, të vështirësive të rritjes e të formimit, të pjesëmarrjes në luftën çlirimtare si antifashist, të përgjegjësive që mori në një prej kohërave më të vështira – në vitet e mëkëmbjes së pushtetit që doli nga lufta dhe të mbrojtjes së tij prej ndërhyrjeve nga jashtë e nga brenda, ka qenë më se e mjaftueshme për një monografi".

Kjo monografi, nuk do ta kishte parë dritën e botimit pa kontributin e drejtëpërdrejtë të pinjollit të denjë të kësaj familje, Lenin Mark Ndrec Vladi. Të shkruash për këtë veteran të kufirit të kombit është sikur të futesh në një galeri me minerale, ku nuk din se kë të çmosh a të marrësh më parë.

Para 40 e kusur vitesh shkova bashkë me Rrahim Pepën, (kryeveterinerin e Kalasë së Dodës) nga Kalaja te Porta e Korabit. Atje, midis barinjve mësova për komandant Lenin Vladin (sot kolonel në pension), që e vlerësonin si njeriun, intelektualin dhe birin besnik të piramidave kufitare. Asokohe ai ishte vërtetë ushtarak model, fisnik, i thjeshtë, i urtë, vigjilent dhe kurdoherë i lidhur me popullin e trevës së Kalasë, Radomirën e Ploshtanin.

Pas 45 viteve, kur lexova librin "Mark Ndrec Vladi i Lurës" të autorit të shquar Preng Vorfi, më buroi nga zemra t'i shkruaj pak radhë gazetës "Veterani".

Fëmijëria, shkollimi, puna e vështirësive, pesha e detyrës të Lenin Vladit, dëshmojnë atë që thonë Kararet e Dheut: "Bëm baba të të ngajël".

Lenin Vladi, bashkë me dy vëllezërit, Ndrecën e Dedën u rritën jetimë, nën kujdesin e nënë Dilës e të fisit të shquar Vladi të Lurës.

Lenini, në çdo stad të jetës demonstroi virtytet e

• *Si shqiponja e kufirit ai ruan në kujtesë nderimin për shumë shokë e intelektualë të shquar si Dine Kaca, Shuaip Methasani, Bajram Stojku, Mehmet Vladi e plot të tjerë. Ky veteran i kufirit ka ditur ta nderojë popullin, brezat, familjen e shoqërinë*

të atit Mark Ndreca, i cili qysh në Lurë, Katër Grykë, Selishtë e kudo shfaqti fisnikëri, burri e nderim për popullin.

Shkrimtari i shquar Preng Vorfi shkruan: "Lenin Vladi, kurrë nuk do të harrojë vështirësitë e mëdha që ka kaluar me efektivat kufitare në Venisht, Radomirë e Ploshtan, nga terreni i vështirë, dimrat e zgjatur, agjentët atmosferikë të rënduar, probleme që kërkonin zgjidhje"(fq. 120 e librit).

Po. Ky është Lenin Vladi, tipik i Bajrakut që mbron kullën, fisin, vllazninë, shokët dhe miqësinë. Bir Lure e nip Mirdite, intelektual mendjendritur me një familje të respektuar dhe me fëmijë që nderojnë Lurën e kombin.

Si shqiponja e kufirit ai ruan në kujtesë nderimin për shumë shokë e intelektualë të shquar si Dine Kaca, Shuaip Methasani, Bajram Stojku, Mehmet



Lenin Vladi

Vladi e plot të tjerë.

Ky veteran i kufirit ka ditur ta nderojë popullin, brezat, familjen e shoqërinë. Ndaj dhe nderohet e respektohet edhe sot në pension si veteran që rrezaton dhe përçon kudo e ngado mirësi dhe vlera. Bashkëshortja, fëmijët, nipërit e mbesat, farëfisi dhe Lura mbarë krenohen me Lenin Vladin. Ai ecën në gjurmët e të parëve, në gjurmët e të atit, nënë Dilës, në gjurmët e fisit e të Lurës kreshnike.

## Kryefamiljari model Qemal Ramadan Zeqaj

(Vijon nga faqja 10)

profesori, dëgjoje fjalën dhe këshillën e tij plot vlerë dhe vëre në jetë, por edhe në kuptimin e profesionit "vidhja" atë sepse ai i bekuar profesion ka shumë te fshehta, ku kryesore është Etika dhe Estetika.

Përveç të të gjithave Endri kishte këto dy gjëra për të thënë: Profesor, Sali Kurti vjen në punë i pastër me buzëqeshjen që rrezaton veç mirësi, me bluzën e bardhë si bora, me këshilla dhe komunikimet që të japin besim të plotë në shërbimin ndaj pacientit.

Vitet kalonin e ai tashmë ishte bërë i vetdijshëm për këshillat e gjyshit të tij.

\*\*\*

Pas punës së ditës, dr. Endri komunikonte me gjyshin. I jepte "oksigenin" e ditës plot dashuri e buzëqeshje që atë gjysh babaxhan e rinonin. Dashunia është jetë.

\*\*\*

Sa herë që bisedoja me Endrin më fliste veç për gjyshin.

Po kush ishte Qemal Zeqaj.

U lind më 1 Maj 1939 në fshatin



Dyshnik të Beratit në një familje të madhe, patriote dhe punëmirë. At-dheu vuante nga plagët e lufrave të njëpasnjëshme. Vendi plot halle. I ati Ramadani njeri i urtë dhe punëtor. Pas çlirimit të vendit çdo gjë ndryshoi rrjedhën e jetës. Familja tashmë ishte bërë e madhe. Katër vëllezër dhe tre motra. Qemali e shihte të atin që punonte me mish e shpirt së bashku me bashkëshorten që fëmijët të mos e ndjenin peshën e jetës. E për t'ja le-

htësuar barrën babait, Qemali u bë "burrë" para kohe në krah të tij.

Të katër vëllezërit e motrat një pas një filluan shkollën. Qemali vazhdoi shkollën 7 vjeçare dhe për arsye ekonomike vazhdoi punën. Binte në sy si djalë punëtor dhe njerëzor. Qe herët i ati e martoi me Hurmanë që ishte moshatare me të. Jeta në çift solli në jetë plot fëmijë që e mbushi shtëpinë me gëzim të pa fund. Më kryesorja është se ato u rritën me plot kulturë.

Dhe Qemali ishte kryefamiljari i respektuar nga të gjithë. Atij që në rininë e tij iu besua detyra si furnitor i kopshteve e çerdheve në kooperativën e Lapardhasë, kudo dhe kurdo korrekt që fëmijëve të mos u mungonte asgjë. Ai si një shërbëtor i denjë kërkonte llogari deri në një.

Vitet kalonin dhe familja rritej. Vëllezërit dhe motrat sejcili krijoi çerdhen e tij. A ka gjë më të shenjtë se në zemrat e të gjithëve tek sejcili mbretëron dashuria.

Ishte 77 vjeç kur u nda nga jeta i vëllai Azbiu. Një pafundësi miqsh e dashamirësh erdhën për ta ngushëlluar, e ai u ishte mirënjohës. E pra këto njerëz erdhën pranë Qemalit e nënës së madhe siç e thërisnin Hurmanë. E si të mos gëzonin ato të dy.

Ja Gëzimi djali i tyre, baba i dy fëmijëve të mrekullueshëm, djalë e vajzë që ka mbaruar studimet për infermiere. Ai u nda nga kjo botë por i kënaqur sepse nipat dhe mbesat ja rinuan pleqërinë duke e vaditur me dashuri.

Ja Endri që e deshi aq fort ka hapur klinikën e tij dentare duke i vënë emrin e pasardhësit të tij "Aiden". Ai sot baba i dy djemve, ruan fotografinë e atij gjyshi të mrekullueshëm. Edhe Gëzimi është i kënaqur për këtë.

## REKUIEM

# DËSHMORËT E RINJ TË FSHATIT VAJZË NË LABËRI

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

**M**aji i dëshmorëve nisi me një aktivitet sinjifikativ në Vajzë të Labërisë në bashkinë e Selenicës. Kompleksi memoristik i ri i Dëshmorëve të fshatit Vajzë në ditën e dëshmorëve në përkujtim të gjakut të dëshmorëve të priti shumë vizitorë nga Tirana dhe nga shumë vende të tjera në 5 majin e këtij viti. Dita-memorie e kujtesës për dëshmorët e Vajzës tregoi se dëshmorët nuk harrohen kurrë, pasi ata janë trupëzuar me historinë me flamurin dhe gjakun e derdhur për liri, ata janë frymëzimi atdhetar, emblemë e krenarisë dhe heroizmit. Në Vajzë kishte ardhur orkestra frymore e Forcave të Armatosura, ministër i Mbrojtjes Pirro Vengu, Zv/Ministri i MM ai edhe anëtar i komisionit Enkelejd Joti përgjegjës nga zëvendësministrat për çështjet e dëshmorëve, Kryetari i Bashkisë Selenicë Nertil Ëngjëllush Bellaj, Prefekti i Qarkut Vlorë Plator Nesturi, ish-prefekti Flamur Mamaj, deputeti Vullnet Sinaj, Kryetari i SHKA "Vajzë" Irfan Birbilaj, Kryetar i SHAK "Labëria" dega e Tiranës, Kryetar i SHKA "Fushëbardha" Nexhip Onjea, kryetar i SHKA "Dukaj" Gazmend Allkaj, Kryetare e OKDA dega Selenicë Shefo Xhaferaj, kryeplaku i fshatit Vajzë Çlirim Fredi Hitaj, sekretari i Përgjithshëm i SHKA "Vajzë" Lefter Tahip Hitaj, kryetari për Dëshmorët dhe pasardhësit e Veteranëve të fshatit Vajzë Rait Refat Kasaj, Nënkryetar i SHKA "Vajzë" Mitat Shahin Bellaj, Fatmir Kaba, etj. Dhe të gjithë për shpërndarjen e certifikatave të dëshmorëve të rinj.

Fshati Vajzë kishte para pesë majit, 27 meteorë lirie që mbanin titullin e lartë "Dëshmor i Atdheut". Për tre vite u përgatitjen dokumentet e 12 dëshmorëve



të rinj, ndërkohë që është fakt se ne nuk bëjmë asnjë lloj zbulimi, por grumbulluam faktet, dokumentacionin që ishte në historikun dhe ish-muzeun e fshatit dhe të Vlorës, që gjendej në librin e birit të shquar të fshatit Vajzë, Gjeneral Maliq Sadushi (ish-zv/MM i parë), i cili në librin e tij "Fshati ynë i mirë", (2002), një libër-testament brezash që thotë: "Një numër jo i vogël patriotësh vajzotë janë ekzekutuar me pushkatim. Padrejtësisht këta patriotë nuk janë shpallur dëshmorë të Luftës Nacionalçlirimtare.

Kjo padrejtësi duhet korrigjuar". Këtë e dëshmojnë dhe 17 anëtarët e komisionit që hartuan të parin historik të Vajzës dhe që realizuan një dëshmi autentike. Në Departamentin e Dëshmorëve pranë MM-së nëpërmjet Prefektit të qarkut Vlorë u dërguan 12 dosje për 12 të rënë të fshatit Vajzë me një volum rreth 1200 faqe, që plotësonin kriteret e Ligjit nr. 109/2018, datë 20.12.2018, "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut", neni 5 "Kriteret për shpalljen ose njohjen e statusit "Dëshmor i atdheut". Ajo që nuk u mundësua në 80 vjetorin e çlirimit të Atdheut, u mundësua në 80 vjetorin e fitores mbi fashizmin. Shpallja e dëshmorëve të rinj është sot një amanet i përmbushur, që flet për luftën, qëndresën, pathyeshmërinë, lumenjtë e gjakut që fshati Vajzë derdhi në themelet e lirisë, Dëshmorët i nderon gjithë bota pasi ata janë vetë historia e kombeve. Dëshmorët janë luftë, gjak dhe histori. Ky lapidar në Vajzë dëshmon historinë, pasi dëshmorët u flasin të gjallëve për të shkuarën, historinë, gjakun e derdhur. Në varrezat e fqinjve tanë në Itali është shkruar ky epitaf: "O ju të gjallë, që vizitoni këto varreza: nëse nga ju nuk zgjatet e nuk rritet lavdia e atdheut, ne kot paskemi vdekur".

Historia e kombit përjetosohet pikërisht në lumenj gjaku për lirinë. Çurçilli i vlerësonte betejat si: "gurët kilometrik më të rëndësishëm

të historisë". Krisma e betejave shqiptare, gjaku i derdhur lumë për lirinë e vendit, edhe gjaku i bijëve e bijave të fshatit Vajzë shkruan lirinë shqiptare, pasi krisma e luftës antifashiste u njoh edhe nga tre fuqitë e mëdha të koalicionit antifashist botëror. Zëri i dëshmorëve të Vajzës dhe gjithë dëshmorëve të kombit shqiptar është një zë i shenjtëruar, një zë që shkroi nder krenari dhe lavdi në librin e artë të shqiptarizmit. Është detyrim mbarëkombëtar për ditën e 5 Majit, ditën e madhe të njerëzve të pavdekshëm, antifashistët e lavdishëm të shekullit të XX-të të nderohen bindshëm dhe me koshiencë të plotë, pasi sikurse gjithë shqiptarët, fshati Vajzë ishte fshati që e mbështeti luftën partizane me shpirt, ndau kafshatën e gojës me luftëtarët e lirisë. Bashkëpunëtorët e fshashizmit, nuk kanë munguar dhe nuk do të mungojnë edhe në Shqipërinë tonë të dashur. Ata mohojnë gjakun e dëshmorëve, minimizojnë deri në shuarje LANÇ-in, kalkulojnë shifra e denigrojnë luftën antifashiste, edhe pse sovranitë popullore ka një shprehje të larë në dritën e diellit: "Kush nuk respekton të rënë, nuk mund të dojë as të gjallët".

Respekti dhe nderimi i të gjallëve për veprën e dëshmorëve është evident, sepse nën drejtimin e SHKA "Vajzë" e posaçërisht të kryetarit Irfan Birbilaj, kryesisht dhe Kryeplakut e pleqësisë janë gjendur ditë e natë që procedurat dokumentare për hartimin e dosjeve të bëheshin sipas ligjit. Sot është rasti të falënderojmë komisionin për statusin e dëshmorit të Atdheut e posaçërisht Ministrin e Mbrojtjes që ju përgjigj kërkesës sonë duke zbatuar ligjin në mënyrë të përpiktë dhe duke shpallur me titullin e lartë Dëshmor të Atdheut 12 bijë e bija të fshatit Vajzë dhe që t'ju mundësohej vendosja e emrit në këtë lapidar lavdie gjithë atyre që gjakun e derdhën për Atdhe për Shqipërinë e lirë para 81 vitesh dhe më konkretisht: Këze Shahin Sulçaj (1898 - 25.12.1943), ishte nëna e dy

dëshmorëve, u ekzekutua nga nazistët gjermanë në fshatin Vajzë.

Pesare Xhezo Kërroçaj (1906 - 30.1.1944) pjesë e grave antifashiste të fshatit Vajzë kapet në befasi dhe ekzekutohet me breshëri plumbash përpara shtëpisë së saj në Vajzë. Ferik Zagoll Bilbilaj (1930-30.11.1943) korrieri i çetës së fshatit, pionieri trim që ra nga plumbat e mitrolozit fashist gjerman dhe u pre nga predha e mortajës, pranë Amonicës te pylli i Kuliut. Dalan Mehmet Kamberaj (1893-16.4.1943) u arrestua nga forcat italiane në kodrat e Ashamirit, në perëndim të fshatit, u shoqërua për në komandën fashiste italiane, duke u mbajtur i lidhur këmbë e duar, u arratis afër Tegesë, dhe tendoi largimin drejt formacioneve partizane fashistët hapën zjarr dhe e ekzekutuan me breshëri automatiku. Beqir Hasko Osmanaj (1898 -28.1.1944) u kap fashistët e bashkëpunëtorët në përroin e madh në veri-perëndim të fshatit, iu dorëzua komandës gjermane, ku u torturua për disa orë e më tej e ekzekutuan përpara kasolles së tij, në afërsi të shtëpive të Sulçajve në Nastasaj. Abdyl Hasko Osmanaj (1910-1944) u kap në Buduvenda të Vajzës, nga gjermanët e torturuan gati një ditë të tërë, duke i kërkuar të tregonte se ku ishin fshehur strehuesit e parizanëve dhe aktivistët e lëvizjes së fshatit dhe meqënëse nuk tregoi u ekzekutua me pushkatim nga gjermanët. Shaho Barjam Selimaj (1890 -28.1.1944) po kthehej në fshatin e tij të djegur e të plaçkitur nga fashistët dhe po kalonte rrugës nga Marovicat për në fshat diktohet nga patrulla gjermane që shkente me motoçikleta gjatë rrugës automobilistike nga Ploça përgjatë fshatit Vajzë.

Gjermanët tentuan të kapnin, por ai u përpoq të largohej dhe për t'ju shmangur ndjekësve; gjermanët hapën zjarr pa paralajmërim duke e lënë të vlarë në rrugën automobilistike afër ullinjve të Vajzës. Delo Mystehak Sulçaj (1929 - 30.11.1943) po zbriste nga mali i Beunit, fashistët dhe bashkëpunëtorët e njihnin Delo Sulçaj si pjesë e familjes të lidhur fuqishëm me luftën partizane e kapin në befasi tek mullinjtë e Vajzës, tek po zbriti në rrugë dhe kur po kalonte drejt përroit u kap dhe e ekzekutuan me pushkatim në afërsi te "Buza e Bletës" në Vajzë.

Sadedin Sherif Hazizaj (1898-18.2.1944) ishte anëtar i Këshillit Nacionalçlirimtar të Vajzës; kapet në mënyrë tinzare, torturohet në mënyrë çnjerëzore si pjesëtar të LANÇ-it dhe si anëtar të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të fshatit dhe më në fund e pushkatojnë. Hito Zenel Hitaj (1830-1878), i ekzekutuar nga osmanët në mëhallën Karavog të fshatit Vajzë të rrethit të Vlorës; ka qenë prijës i çetës së Vajzës dhe pjesë e kryengritjeve kundër pushtuesve osmanë; i përket periudhës së LSHP pasi ka rënë në

(Vijon në faqen 15)



## SUPLEMENTI LETRAT

Shkrimtari dhe luftëtari nga Kurveleshi, që erdhi nga lufta

# Xhafer Matuka shkroi për luftën, për heronjtë dhe për ushtrinë



Nga Sakip Cami

Libra të autorit Xhafer Matuka

1. Bateria e kepit të largët", roman, 1973
2. "Ai ishte tigr", tregime, 1969
3. "Meleq Gosnishti", monografi, 1977
4. "Selam Musa Salaria", monografi, 1975
5. "Mustafa Matohiti", monografi, 2008
6. "Takim në luftë", tregime, 1971
7. "Vidohovë, 2 gusht 1949, kronika dhe kujtime për provokacionet e gushtit 1949, botuar në vitin 1968
8. "Kurvelesh zemra ime", kushtuar Memo Metos, 1972
9. "Obelisk përjetësie", shënime për jetën e Xhafer Matukës, 2008

Xhafer Matuka, shkrimtari dhe luftëtari nga Kurveleshi, që erdhi nga lufta dhe që shkroi për luftën, për heronjtë dhe për ushtrinë, ka lindur në Nivicë të Tepelenës. Që në moshë të re 15 vjeçare i bashkohet Luftës Antifashiste të popullit Shqiptar.

Pas mbarimit të Shkollës Ushtarake "Skënderbej" shkon për Studime në Ish - Bashkimin Sovjetik për artilerier bregdetare.

Pas mbarimit të Akademisë Ushtarake në B.S. emërohet në Forcat Detare dhe punon fort për ngritjen e armës së Artilerisë Bregdetare.

"Xhaferin e njoha në ditët e zjarra të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, kur ai ishte partizan 13 - 14 vjeçar", tregon Gjeneral Rahman Parllaku[1], Heroi i Popullit.

Mbas mbarimit të luftës, Xhaferi, vetëm 14 vjeç pranohet në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej" dhe me mbarimin e saj së bashku me

- Vepra e tij dallonte për temën që trajtonte. Xhaferi shkroi për heronjtë e luftës, për Selam Musain e Luftës së Vlorës dhe për heronjtë e Luftës Antifashiste nacionalçlirimtare si për Memo Meton, Mustafa Matohitin, Meleq Gosnishtin dhe për shokët e tij të luftës




Rustem Peçin dhe Gjergj Titanin studiojnë në Riga të Letonisë (Ish Bashkimi Sovjetik), për artilerier bregdetare. Pas ardhjes në atdhe ata ishin oficerët më kontributorë të armës së artilerisë bregdetare në ushtrinë e re shqiptare të pasluftës.

Xhaferi ngjiti shkallët e hierarkisë ushtarake me meritë deri sa arriti të bëhej zv.komandant i Forcave Ushtarake Detare për Artilerinë Bregdetare.

"Njohja me Xhaferin, vijon Gjeneral Rahman Parllaku, u përsërit pas 17 vitesh, më 1961 kur u krijua Komanda e Forcave Ushtarake - Detare (FUD). Unë u emërova komandant i këtyre forcave dhe kisha në vartësi edhe Flotën Detare dhe Artilerinë Bregdetare). Zëvendëskomandant për Artilerinë Bregdetare u emërua Xhafer Matuka.

Tani po takohesha me një Xhafer, burrë të pjekur, oficer i kualifikuar, me një horizont të gjërë kulturor, studiues jo vetëm i literaturës ushtarake, por edhe asaj historike e artistike. Madje ai kishte filluar të shkruante e të botonte libra.

Xhaferi në komunikim me shokët kishte një humor të këndshëm, me një ironi të hollë dhe herë-herë qëndisëse për servilet e të pasinqertët. Aftësitë profesionale, niveli kulturor dhe personaliteti i tij, i



mundësuan Xhaferit pranimin edhe në shoqërinë ushtarake.

Por njerëzit me kulturë e personalitet në atë kohë viheshin në dyshim dhe cmirëzitë në shërbim të sigurimit të shtetit sajnin shpifje, përgjonin e intrigonin. Dhe për fat të keq, të tillë u gjetën edhe në rrethin ushtarak e krahinor të Xhaferit. Ata ja sajuan kurthin edhe këtij personaliteti të njohur".

Edhe pse i shpëtoi ndëshkimit e përjashtimit nga partia, ai mori masë nga Ministria e Mbrojtjes, duke e transferuar në detyrë më të ulët, komandant grupi i Artilerisë Bregdetare në Durrës. Pa marrë parasysh qëndrimin që mbante, Xhaferi survejohej e ndiqej nga organet e sigurimit, por ai që i kujdesshëm e diti t'u shmangej provokimeve të tyre.


Komanda, duke vlerësuar aftësitë profesionale, përkushtimin në punë dhe si studiues, i propozoi Ministrisë dhe ajo e transferoi Xhaferin me detyrë në Institutin e Studimeve Ushtarake.

Krahas punës studimore në fushën ushtarake Xhafer Matuka ishte edhe një shkrimtar i vlerësuar me cmime kombëtare.

Vepra e tij dallonte për temën që trajtonte. Xhaferi shkroi për heronjtë e luftës, për Selam Musain e Luftës së Vlorës dhe për heronjtë e Luftës Antifashiste nacionalçlirimtare si për Memo Meton, Mustafa Matohitin,

(Vijon në faqen 14)

## HERONJTË



Nga QAZIM SHEHU

Mendja nuk i krijon heronjtë  
Ata janë dhe u bënë të tillë  
Për ne pa pasur nevojë  
Siç nuk ka një lis në pyll...

Heronjtë njerëz ishin si ne  
Po një çast prej nesh u shkëputën  
Për të krijuar një këngë të re  
Me çiftelinë dhe lahutën...

Kënga për ta rron me ne  
Ata jetojnë veç në lavdi e nder  
Por shpesh habiten pse s'e vëmë re  
Kur kaq lart i ngremë për habi...

Mungesën e guximit kur justifikojmë  
Ata që donim ta bënim ne,  
Dhe me këtë trill vazhdojmë e rrojmë  
Kur idealet hedhim përdhe.

## Një trup, një shpirt



Nga Arben Alliu

Një trup një shpirt,  
Bashkë të behemi ne;  
Për Shqipërinë e dashur,  
Për këtë mëmëdhe.

Për shqipen e shumvëuajtur,  
Të përçarë e sakatosur,  
Aq shumë e lodhur;  
Shpesh here gjakosur.

Le ti lëmë hatërmbetjet,  
Ti hedhim në det,  
Jemi të një gjaku  
Flamuri na thërret.

Një trup, një shpirt  
Një gjak jemi ne,  
Ane kand botes  
Me të madhin Skënderbe.

## SUPLEMENTI LETRAT

Homazh dhe nderim në shekuj për dëshmorët xhenier

## Dëshmorët e xhenios shqiptare në një libër



**Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj**  
Mjeshtër i Madh

Libri “Dëshmorët e armës së xhenios” (1936-2024) të autori ushtarak Zabit Çuku, paraqet mjaft interes dhe i ardhur në kohë për publikun e gjërë. Autori për vite ka punuar dhe mbledhur material për të rënë në krye të detyrës luftarake. Si mision fisnik, autori në libër ka dhënë një panoramë të përgjithshme dhe ka identifikuar e publikuar listën e të rënëve në krye të detyrës heroike për interesat e atdheut. Në këtë prurje të re ne njihemi me kuadro, ushtarë, civilë që kanë shërbyen në armën e xhenios në vite, dhe kur ka ardhur momenti ata kanë bërë sakrificën më të madhe duke lënë jetën në kushte e rrethna të ndryshme në detyrë dhe për shkak të saj.

Libri vjen si një mirënjohje dhe si një homazh për të gjithë ata heronj të rënë në krye të detyrës e që duhen kujtuar, për veprën sublime që kanë kryer. Autori ka ditur që në pak rreshta të sjell histori nga më të ndryshme, duke theksuar se kujtimi i të rënëve nuk është thjeshtë një ceremonial protokollar, një ditë përkujtimore e dhënies së jetës së tyre, por një detyrim njerëzor dhe me vlera për të gjithë.

Libri i autorit ushtarak Zabit Çuku është dhe një nderim për të rënë, por njëkohësisht një homazh për jetën, veprën dhe përkushtimin e tyre në kryerjen e detyrës ushtarake. Nëpërmjet faqeve të librit ne gjejmë pavdeksinë e përvetshme të emrave të dëshmorëve xhenierë, oficerë, nënoficerë, ushtarë dhe civilë që shërbyer në LANÇ, në Ushtrinë Popullore dhe në FA e që kanë dhënë jetën, duke u sakrifikuar për të kryer detyrën në armën e xhenios, e në emër të Atdheut.

Nëpërmjet këtij libri autori shfaq respektin për familjarët e të rënëve, të cilët duhet të jenë krenar për bijtë e tyre që dhanë jetën për atdheun, pasi në faqet e tij gjendet vepra dhe heroizmi i tyre. Libri na vjen dhe si një kujtesë e shërben për organet shtetërore, për kujdesin, respektin dhe nderimin e të rënëve, por dhe të familjeve të tyre, pra të dëshmorëve të armës së xhenios. Gjithshtu libri thekson dhe rëndësinë që shoqëria jonë ushtarake dhe qytetare duhet të shfaqë në ruajtjen dhe nderimin e historisë së vendit, të memories së ushtrisë për ushtarakët e saj që dhanë jetën për atdheun.

Nëpërmjet faqeve të librit ne njihemi me evidencimin e nisur nga viti 1936 dhe përfundon në korrik 2024, ku autori ka evidentuar 165 dëshmorë të rënë, si dhe mjaft të plagosur në armën e xhenios shqiptare. Libri fillon me të dhënat për dëshmorët, na përshkruar heronjtë e popullit dhe të punës, dëshmorët xhenierë në LANÇ, dëshmorët në provokacionet e gushtit 1949, dëshmorët për çminimet nga minat në vitet 1945-1967, të rënë

gjatë punimeve operative, të rënë në fortifikim 1968-1987, dëshmor të shumë ngjarje të ndodhura gjatë viteve deri në vitin 2024. Libri vjen si një enciklopedi që ushtaraku Zabit Çuku, është munduar dhe ja ka arritur qëllimit të japë shumë të dhëna për jetën e çdo dëshmorë, por dhe të plagosuri dhe të ngelur i gjymtuar tërë jetën.

Autori bën thirrje që brezat të mësojnë kush janë të rënë, të përjetësohet e hidhura mbi tokë, e të mësohet prej saj. Gjurmët e heroizmit dhe të sakrificës së tyre në libër, na tregojnë se jetët njerëzore të humbura nga ushtarakët xhenierë, ka qenë i dhimbshëm. Në libër si në një apel ushtarak gjendet emra ku secili ka lënë një amanete, ka lanë fëmijët jetimë, ka lënë prindërit me zemër të tharë... Autori si në përmbajtjen e përgatitjes të jetëshkimeve është munduar të zbatojë një standard, duke na e prurë dëshmorin që nga prejardhja, fëmijëria, shkolla dhe momenti i ngjarjes në të cilën ai ka dëshmuar me rënie e tij. Autori ka pasë si synim të bëjë ringjalljen e të rënëve në strukturat xheniere, të Ministrisë së Mbrojtjes, për një nderim të merituar të tyre, në dhënien e pavadshmërisë së tyre në përjetësi dhe ndër breza të historisë shqiptare. Diku autori shprehet se përkujtimi e nderimi i të rënëve xhenierë dhe shpërblimi i familjeve të tyre është detyrim brezash, është detyrim i të gjallëve, i organeve shtetërore, i FA. Vlerësimi i të rënëve është një detyrim sikurse edhe statusi “Dëshmorë Atdheut” duke konsideruar, se të gjithë të rënë në detyrë janë të njëlojtë me ata që kanë rënë në luftërat e shqiptarëve, për mbijetesën nëpër shekuj, për mbrojtjen e atdheut, për të merituar ngritjen e një memoriali në një vend të dukshëm në Durrës apo në Tiranë. Libri i bën thirrje dhe Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmorë i Atdheut”, Organizatës së Dëshmorëve të Atdheut (OKDA), për t’i njohur e rivlerësuar propozimet e bëra nga prefektura, këshilla të Qarqeve e Bashkive me kërkesat e lutjet e familjarëve lidhur me dhënien e statusit, kur rrethanat vërtetohen se humbja e jetës ka ardhur si pasojë e përmbushjes së detyrës të ngarkuar nga ushtria.

#### LARTËSIM FIGURËS SË USHTARAKUT XHENIER

Nëpërmjet leximit të librit shohim dhe adhurimin e përpjekjet e autorit Zabit Çuku, për të bërë në heshtje dhe me durim një punën shoqërore dhe patriotike. Askush nuk i vuri detyrë, por ai e ndjente se duhej shkruar diçka për këta bij të popullit shqiptarë, që jetën e tyre e sakrifikuan për Atdheun.

heun. Në libër autori ka materializuar një pjesë të rëndësishme të kohës, të diturisë, të përvojës e respektit për kolegët e tij të rënë në krye të detyrës. Një pjesë të dëshmorëve autori ka pasur fatin që të punojë dhe ti njohë drejt për drejtë ata.

Zabit Çuku, një ushtarak, një profesionist i mirëfilltë xhenier ka punuar për shumë vite në Ushtrinë Popullore Shqiptare. Gjatë kësaj kohe ai ka pasë një angazhim serioz, ka bërë studime dhe mbajtur shënime, duke arritur të kërkojë, të hulumtojë në arkiva, me takime e në qindra fletë dokumentare, ka udhëtuar shumë nëpër reparte xheniere e në Shqipëri, ka kontaktuar me familje e me kolegë të oficerave, nënoficerave, të ushtarëve, të civilëve xheniere të rënë në krye të detyrës.

Autori ka kërkuar dhe ka lexuar libra e gazeta, të cilat i ka qemtura dhe mbajtur shënime e evidentuar për të saktësuar dhe krijuar besueshmërinë për ngjarjet e ndodhura në vitin 1936 me heroizmin xhenier shqiptar të treguar nga dëshmorë Xhemal Kada, Hero i Popullit në Luftën e Spanjës në vitin 1936-1939. Këtë e ka bërë me përgjegjësi për të sjellë para lexuesve një përmbledhje e dëshmi të rëndësishme për ndërgjegjen individuale, shoqërore dhe kombëtare.

Me këtë punim serioz dhe shkencor, autori na ka bërë një shërbim të madh publik, por dhe shtetëror, duke vënë në funksion të familjarëve të të rënëve xhenierë këtë libër. Aty familjarët dhe Organizata e Dëshmorëve të Atdheut gjen në çdo faqe të librit një emër të ri, një ngjarje dhe një hero, një arsye më shumë për të qenë krenarë për sakrificën e treguar nga bijtë e tij, në emër të Atdheut.

Libri është një kontribut tepër i rëndësishëm, për kohën në të cilën kalojmë, por dhe për mbarë shoqërinë tonë. Nëpërmjet jetëshkrimeve dhe fotove të dëshmorëve, të atyre burrave fisnik dhe të rinjve që të mirrin gjak në vetull, të gjithë janë të përmbledhur në faqet e këtij libri historik. Çdo shqiptar i ndershëm që lexon dhe shikon këtë libër që dëshmon për një sakrificë të madhe të bijëve të tij, por është dhe ftesë për reflektim të thellë për çdo shqiptar, për çdo qytetar, për jetën dhe për shoqërinë e lirë. Me këtë libër autori na kujton të gjithëve se dikush ka rënë, ka humbur jetën për atdheun. Ai na kujton se shumë fëmijë u rritën jetimë, me vështërsi, për arsye se baballarët e tyre dhanë jetën për Atdheun. Autori na kujton se të gjithë kemi përgjegjësi përballë familjeve të Dëshmorëve, por në mënyrë të veçantë organet shtetërore.

(Vijon në faqen 15)

## Xhafer Matuka shkroi për luftën, për heronjtë dhe për ushtrinë

(Vijon nga faqja 13)

Meleq Gosnishtin dhe për shokët e tij të luftës.

Vecanërisht me vlerë është libri “Vidohovë, 2 gusht 1949” që është një ditar lufte.

Është kuptimplotë deponimi në kujtimet e ish komandantit të postës kufitare në Vidohovë. Xhafer Matuka (Vidohova 2 Gusht 1949, Tiranë 1968 faqe 84), ku ndër të tjera thuhet se trupat greke lanë të vrarë në tokën shqiptare rreth 300 ushtarë e oficerë, rreth 590 të plagosur dhe 270 robër, ndërsa nga forcat tona për 10-12 ditë lufte të përgjakshme deri në bajonetë me bajonetë, mbetën të vrarë 29 ushtarë e oficerë dhe 127 vetë të plagosur si dhe dëme të ndjeshme materiale.

Libri me tregime “Takim në luftë” trajton krye-

sisht temën e luftës dhe u kushtohet shokëve të luftës.

Tema e mbrojtjes së Atdheut dhe e ushtrisë trajtohet te romani “Bateria e kepit të largët”, “Vidohovë, 2 gusht 1949, kronika dhe kujtime” dhe në librat e tij me tregime.

Shoqata Atdhetare Kulturore “Nivica” e ka nderuar me Çertifikatë Mirënjohje për veprimtarinë e tij ushtarake dhe letrare në vitin 2009.

Më 20 tetor 2012 Komuna e Kurveleshit e ka nderuar birin e saj, Xhafer Matuka, me titullin “Qytetar Nderi”.

[1] Nga fjala e Gjeneral Rrahman Parllakut në ShQUP me rastin e shpalljes Qytetar Nderi të Kurveleshit, 20.10.2012

## SUPLEMENTI LETRAT

# Dëshmorët e xhenios shqiptare në një libër

(Vijon nga faqen 14)

## NJË NJOHJE ME AUTORIN USHTARAK ZABIT ÇUKU

Zabit Ahmet Çuku, ka lindur më 20 janar 1950, në Rrajcë të Përrenjasit. Ka kryer arsimin e mesmë dhe ka përfunduar Shkollën e Lartë Ushtarake në Tiranë. Ka kryer detyra të ndryshme ushtarake në vitet 1972-2004 si në batalion-regjimentet e Kavajës, Porto-Palermos, në Vlorë, në komandën e Divizionit të Xhenio, në Drejtorinë Logjistike të Shtabit të Përgjithshëm. Ka bërë në vijimësi kurse dhe trainime brenda dhe jashtë vendit. Ka dalë në rezervë me urdhër të MM nr. 8485, datë 29 tetor 2004 me gradën ushtarake Nënkolonel. Në vitet 2004-2015 ka punuar me projektet humanitare, demontim, e asgjësim të municioneve.

Nga vitit 1998 dhe në vazhdim ka bërë shkrime në gazeta të ndryshme si në "Ushtria", "Mokra", "Domosdova", "Çermenika", "Kushtrim Brezash", "Veterani", "Alpet", "Librazhdi", "Labëria", "Gora", etj. Është veprim-



tar i palodhur dhe i anëtarësuar në: kryesisë së Shoqatës të Xhenierëve nënkryetar i Shoqata Atdhetare-Kulturore "Pelioni" 1999-2016; anëtar i drejtues në OVPA njësia nr. 3 Tiranë

nga 1988 dhe në komitetin e VPA të Tiranës në vitet 2018-2022.

Ka botuar librat: "Historia e armës së xhenios në Shqipëri", "Rrajca nëpër udhët e historisë"; "Portrete të xhenierëve shqiptarë", Pjesa e Parë; "100 vjetori arma xhenios Shqipëri" Pjesa e Dytë; "Mbresa 52 ditë, Detroit Michigan SHBA"; "50 vjet me shokët e një klase"; "50 vjet jetë familjare"; "Historiku VPA FD, Zonës-3 Tiranë"; "Dëshmorët e armës së xhenios" (1936-2024). (një pjesë me bashkëautorë)

Për punë të mirë dhe rezultate të dukshme është vlerësuar me: "Medaljen e Shërbimit Ushtarak", "Urdhëri Ylli i Kuq" Klasi III, "Medalje për Shërbime", "Medalje 40 vjetori çlirim-it të Atdheut" si dhe dëshmi "Vullnetar i dalluar", "Mirënjohje nga MM", "Mirënjohje nga instancat shtetërore dhe të NATO-s", "Nderi Organizatës së Veteranëve të LANÇ", "Mirënjohje" nga Shoqata "SHKRUSH" etj.

(Marrë nga gazeta Gazeta Destinacioni - 03/05/2025)

## DËSHMORËT E RINJ TË FSHATIT VAJZË NË LABËRI

(Vijon nga faqja 12)

prag të LSHP më 1878. Resul Beqo Resuli/Onjea (1869-1897), me origjinë nga fshati Vajzë, (bazuar në historikun e fshatit Vajzës), dhe fshatit Fushëbardhë të Gjirokastrës ka rënë në Luftën e tretë për mbrojtjen e truallit shqiptar në Vilajetin e Janinës në mars të vitit 1897.

Azbi Nurçe Hitaj (1900-10.2.1945), që ka ndër-ruar jetë nga torturat e tmerrshme fashiste në moshën 45 vjeçare. Azbiu kishte tre vajza dhe që të tre kanë qenë partizane. Në shtëpinë e Azbi Nurçe Hitaj u krijua Këshilli Nacionalçlirimtar i Vajzës. Për këtë si antifashist u arrestua, burgos, torturua për dy vjet, provoi torturat më çnjerëzore të nazifashistëve. Shtëpia e tij u shemb me predha topi, që rrafshuan shtëpinë prej guri, por nuk mund të shuajnë historinë. Në fund të nëntorit 1944 u kthye në fshat pothuaj i vdekur, me plagë të shumta torturash dhe që pas tre muajsh më 10.2.1945, në agun e lirisë ndërroi jetë nga plagët.

Nuk vdiq nga mosha por nga plagët e torturat e luftës. Fashistët i shkaktuan Azbi Hitaj plagë shumë të rënda në trup por dhe goditje të rënda psikike, të cilat e sakatuan tmerrsisht, për të mos u kthyer më kurrë në gjendjen e mëparshme dhe që mbriti në ditën e çlirimit të vendit pothuaj i vdekur dhe i pakallur. Është padyshim një prej heronjve të këtij fshati, është dhe do të ngelet në përjetësi dëshmor pasi dosja e tij ka më shumë se njëqind faqe, dëshmi të ish-luftëtarëve të luftës antifashiste partizane.

Ai do të ngelet përjetësisht në dokumentat e shtetit dhe si një kujtesë për fshatin Vajzë, një kujtesë për ndërgjegjen popullore edhe të atyre që mund të shkelin këtë të drejtë ligjore, hyjnore, morale e historike, edhe për ata që formulojnë e fabrikojnë të dhëna për hir "të pronësisë". Por dëshmorët janë të kombit, janë të Shqipërisë. Gjaku i derdhur për Atdheun është gjithësesi në të gjitha epokat mbi gjithcka. Atdheu është i të gjithë shqiptarëve dhe maksima proverbiale popullore "e drejta zhytet por nuk mbytet" vonon por nuk harron, e vërteta gjithmonë triumfon.

Të gjithë familjarët që erdhën në Vajzë këtë herë ishin pjesë e armatës që mbajnë lartë idealin e dëshmorëve, Shqipërinë e lirë dhe të begatë

ta transmetoni si amanet të shenjtë nëpër breza. Grupi organizator në Vajzë dhe Tiranë po përgatit librin për 39 dëshmorët e fshatit Vajzë "Yje mbi Beun", përfshi dëshmorët e rinj të shpallur këtë 5 maj si trashëgimi e fshatit Vajzë, si dhe e brezave që do të vijnë, pasi vepra luftarake antifashiste e dëshmorëve të Vajzës do jetojë në përjetësi. Gjaku i dëshmorëve të lirisë, i bijëve e bijave të fshatit Vajzë dhe mbarë kombit shqiptar mori vëmendjen edhe strukturës më të lartë të Komisionit të Statusit të dëshmorëve dhe personalisht të Ministrisë të Mbrojtjes që shpërndau certifikatat e dëshmorëve të rinj të Atdheut dhe më konkretisht: Ferik Zagoll Bilbilaj, Dalan Mehmet Kamberaj, Këze Shahin Sulçaj, Pesare Xhezo Kërroçaj, Beqir Hasko Osmanaj, Abdyl Hasko Osmanaj, Delo Mysterhak Sulçaj, Sadedin Sherif Hazizaj, Shaho Barjam Selimaj, Hito Zenel Hitaj, Resul Beqo Resuli (Onjea), ndërsa dosja e Azbi Nurçe Hitaj patrioti e luftëtari i flaktë që vdiq nga torturat fashiste më 10.2.1945 është në proces dhe ne jemi të sigurtë për shpalljen e tij dëshmor sipas gjithë procedurave e normave standarde të legjislacionit shqiptar për dëshmorët.

Shpërndarja e certifikatave dhe dhënia e flamurit "Familje Dëshmori" është realizuar në ditën e dëshmorëve më 5 Maj 2025 në Vajzë të Vlorës. Në proces të përgatitjes së dosjes për titullin dëshmor janë edhe Rrapo Ferhat Bellaj (1877-1920), i cili ka rënë në janar të vitit 1920, në moshën 43 vjeçare në mbrojtje të Kongresit të Lushnjës, një nga ngjarjet më madhore të shekullit që vendoste fatet e shqiptarëve pas pavarësisë së Shqipërisë të 1912-tës, si dhe në proces është dhe Shefit Qamil Duka në luftën e madhe të Vlorës, ndërkohë që është edhe një ngjarje, një vrasje e dhimbshme gjatë LANÇ-it, ajo e partizanes Vojsava Hitaj (e motra e Donikës dhe Habesë, që të dyja pjesë e formacioneve partizane) e bija e Azbiut dhe Manushe Hitaj (që ishte si një rast identik si i Ramize Gjebresë).

Opinionin në Vajzë dhe jo vetëm ruan në kujtesë kohën e luftës kur në shtëpinë e Azbiut dhe tre vajzave të tij partizane ishte ngritur Këshilli Nacionalçlirimtar. Ruhet në kujtesë shtëpia e Azbi Hitaj që ja shëmbën fashistët me 12 të shtëna topi, Azbiu i burgosur e torturuar deri nga ana psikike,

ky patriot e luftëtari i flaktë që vdiq nga torturat fashiste më 10.2.1945 e bën rastin si një mungesë të theksuar të mohuar në dekada. Përgatitja dokumentare e dosjeve për të rënë është detyrim i gjithë strukturave që mbrojnë gjakun e të rënëve për liri, pavarësi dhe çlirim kombëtar në Shqipëri. Gjykojmë se e drejta dhe e vërteta, drejtësia do triumfojë dhe Azbi Hitaj dhe e bija në të ardhmen do të shpallen dëshmorë të Atdheut.

Kryetari i Komisionit të statusit "Dëshmor i Atdheut", ai dhe Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu u shpreh para pasardhësve të familjeve të dëshmorëve, përfaqësuesve të institucioneve dhe banorëve të zonës me fjalë të zgjedhura: "...kjo nuk është thjeshtë një ceremoni nderimi, por një akt i drejtë moral dhe historik. Shpallja e 11 bijve të fshatit Vajzë "Dëshmorët të Atdheut", është një borxh, që historia u ka atyre që nuk jetojnë më dhe që jetën e tyre nuk e lanë në rehati, por formë-suan rezistencë, u bënë ballë sfidave të mjegullta të kohës që jetuan dhe dhanë frymën e fundit kurorëzuar me simbolin e Atdheut. Këtu në Vajzë, çdo pëllëmbë tokë është dëshmitare e përpjekjeve të përgjakshme për lirinë dhe dinjitetin.

Vajza është një truall ku trimëria ka gjetur imazhin e vet ndër breza, ku një copëz hartë Shqipërie e munduar nga luftërat, ku hasim një përqendrim të pazakontë trimash. Dhënia e statusit të "Dëshmorit të Atdheut" për njëmbëdhjetë të rënë të periudhave të ndryshme historike, sot është një premtim ndaj së shkuarës dhe historisë, për më tepër një përgjegjësi e re përballë sfidave, që koha na dikton.

Obligimi ynë nuk mund të fillojë dhe të mbarojë te lapidarët apo certifikatat, por shumë më tepër se kaq, është një stafetë brezash. Vetëm kur flamuri krenar i dëshmorëve tanë të valojë si i barabartë mes të barabartëve në selinë e Bashkimit Evropian, do të ndiejmë veten të lehtësuar nga ky detyrim i yni ndaj këtij trualli dhe dëshmorëve tanë, për të qenë në lartësinë e idealeve të të rënëve dhe për të çuar më tutje amanetin e tyre për Shqipërinë. Mirënjohje dhe respekt për kontributin e paçmuar të të gjithë dëshmorëve që dhanë jetën për Atdheun. Kujtimi i tyre të jetë bekim i brezave që do të vijnë! Lavdi dëshmorëve të fshatit Vajzë dhe dëshmorëve të Shqipërisë!"

## FOTOREPORTAZH

80 VJETORI I FITORES MBI NAZIFASHIZMIN - FEDERATA SHQIPTARE E VETERANËVE TË LUFTRAVE PËR LIRI E PAVARËSI – SESION JUBILAR NË GJAKOVË

# TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU: KRENARË QË JEMI PASARDHËS TË FITIMTARËVE



izioneve tona, duke dhënë një kontribut të veçantë në luftën antifashiste. Populli ynë në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi dhe kudo në trojet etnike është krenar që u bashkua me luftën në Aleancën e Madhe Antifashiste të popujve. Trojet tona jo vetëm që u çliruan pa ndërhyrjen direkte të forcave aleate, por dhanë një kontribut të çmuar në këtë luftë. Në këtë përvjetor, ne shprehim falënderimet tona për ndihmën që na dhanë aleatët e mëdhenj — Anglia, Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës — që shkatërruan bishën naziste dhe siguruan lirinë për popujt. Lavdi dëshmorëve të kombit tonë që ranë në të gjitha luftërat për liri!



(Vijon nga faqja 3)

Luftimet tona në ato vende u zhvilluan në kushte të vështira, të ngjashme me dimrin e vitit 1943-1944

në Shqipëri, me mungesë të theksuar të ushqimeve dhe mjeteve jetësore.

Megjithatë, forcat tona e kryen detyrën me nder. Gjatë këtyre luftimeve ranë rreth 600 dëshmorë të dy div-

\*Tatjana Parllaku Çarkaxhiu – Kryetare e OBVL P & Ish këshilltare e Presidentëve të Republikës së Shqipërisë, Moisiu e Topi